

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5541
E mërkurë, 1 gusht 2018
çmimi 0.40 €

Kosova, optimiste se liberalizimi i vizave do të përmbyllet këtë vit

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PRESIDENTI I KOSOVËS, HASHIM THAÇI, KA MBAJTUR KONFERENCË PËR MEDIE LIDHUR ME ECURINË E PROCESIT TË DIALOGUT KOSOVË - SERBI

FAQE 4-5

Thaçi: S'ka forcë që na detyron të diskutojmë për ndarjen e Kosovës



Presidenti Hashim Thaçi i ka siguruar qytetarët se nuk do të ketë forcë që do ta detyrojë Kosovën të diskutojë e lëre më të pajtohet me ndarjen e saj. Ai ka premtuar se kjo çështje nuk do të jetë pjesë e agjendës së procesit të dialogut

në mes të Kosovës dhe Serbisë. Këto komente shefi i shtetit i ka bërë të martën në një konferencë me gazetarë, ku ka bërë me dije se nuk do të ketë as bosnjëzim të Kosovës dhe as Ahtisari+. Presidenti Thaçi ka kërkuar unitet nga

faktori politik për fazën finale të dialogut me Serbinë, duke u bërë thirrje partive politike t'i lënë anash interesat personale e partiake dhe të rreshtohen në shërbim të interesave të shtetit dhe të qytetarëve

AKTUALE

BISEDIMET ME SERBINË TË NDËRPRITEN OSE TË NGRIHEN PËRKOHËSISHT

F.11



Shyqyri HAXHA

SHTATORE, AUTOSTRADË E PARK ME EMRIN E DEMAÇIT

F.3

GENTIANA BEGOLLI ZGJEDHET KRYETARE E AGK-së

F.6

VARROSET AKTORI DHE REGJISORI BEKIM LUMI

F.13

EKONOMI

THEMELOHET GRUPI PUNUES PËR VLERËSIMIN E ASETVE TË 'TREPÇËS'

F.9

29 STUDENTË NISIN PUNËN PRAKTIKE NË ATK

F.8

KULTURË

QEVERIA MIRATON MARRËVESHJEN PËR PROGRAMIN 'EVROPA KREATIVE'

F.13

SPORT

SHUMË OFERTA PËR BALAJN, E ARDHMJA AFËR PRISHTINËS

F.16

MINISTRI GASHI: SPORTI I RAGBIT DUHET TË PROMOVOHET NË KOSOVË

F.16



Foggo: NATO-ja e gatshme ta ruajë sigurinë e Kosovës

Admirali amerikan James Foggo, komandant i Komandës së Forcave të Bashkuara Aleate në Napoli, i cili ka vizituar të martën bazën ushtarake të KFOR-it, Nothing Hill, në afërsi të Leposaviqit, ka thënë se NATO-ja do të vazhdojë t'i përkrahë institucionet e Kosovës dhe të ofrojë siguri për qytetarët

FAQE 5

Shënon rënie numri i udhëtarëve me tren, rritet ai me aeroplanë

FAQE 9



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

DASH-i kritikon Qeverinë shqiptare për korrupsionin e lartë

Në raportin e DASH-it për klimën e investimeve për Shqipërinë për vitin 2018, mbizotërojnë shqetësimet për korrupsionin, mungesën e transparencës në tenderë, teksa Shqipëria konsiderohet vend i vështirë për të bërë biznes dhe ku favorizohen kompanitë e lidhura me politikën



WASHINGTON, 31 KORRIK - Departamenti Amerikan i Shtetit (DASH) ka publikuar raportin e pritur për klimën e investimeve për Shqipërinë për vitin 2018 që edhe këtë vit është tepër i ashpër. Në të mbizotërojnë shqetësimet për korrupsionin, mungesën e transparencës në tenderë, teksa Shqipëria konsiderohet vend i vështirë për të bërë biznes dhe ku favorizohen kompanitë e lidhura me politikën. Me shqetësim raportohen edhe projektet e partneritetit publik privat të cilat vlerësohet se kanë kufizuar konkurrencën, ndërsa nuk ka një analizë kosto-përfitime të tyre. Tjetërsimi i pronësisë është një tjetër problem që kanë raportuar investitorët e huaj.

Raporti thotë se investitorët e huaj përmendin korrupsionin, veçanërisht në gjyqësor,

mungesën e transparencës në prokurimin publik dhe zbatimin e dobët të kontratave si probleme të vazhdueshme në Shqipëri. "Në vitin 2016 Qeveria shqiptare kaloi ndryshime gjithëpërfshirëse kushtetuese për ta reformuar sistemin gjyqësor të vendit dhe për ta përmirësuar sundimin e ligjit. Zbatimi i reformës gjyqësore është duke u zhvilluar, duke përfshirë verifikimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve për pasuri të pashpëguara, por investitorët e huaj e perceptojnë klimën e investimeve si problematike dhe thonë se Shqipëria mbetet vend i vështirë për të bërë biznes", thuhet në raport.

"Investitorët raportojnë shqetësimet të vazhdueshme, pasi rregullatorët përdorin legjislacionin dhe rregulloret e vështira për t'u interpretuar si

mjete për t'i dekurajuar investitorët e huaj dhe për t'i favorizuar kompanitë e lidhura me politikën. Rregulloret dhe ligjet që rregullojnë veprimtarinë e biznesit ndryshojnë shpesh dhe pa konsultime kuptimplotë me komunitetin e biznesit. Investitorët e huaj të mëdhenj raportojnë presion për të punësuar nënkontraktorë të lidhur politikisht dhe shprehin shqetësimin për pajtueshmërinë me Aktin e Praktikave të Korrupsionit të Huaja gjatë operimit në Shqipëri. Raportet e

korupsionit në prokurimin e Qeverisë janë të zakonshme. Përdorimi në rritje i kontratave të partneritetit publik privat (PPP) ka ngushtuar mundësitë për konkurrencë, përfshirë edhe investitorët e huaj, në infrastrukturë dhe sektorë të tjerë. Analizat e dobëta kosto-përfitim dhe mungesa e ekspertizës teknike në hartimin dhe monitorimin e kontratave PPP janë shqetësimet të vazhdueshme. Qeveria kishte nënshkruar më shumë se 200 kontrata PPP deri në fund të vitit 2017", thuhet në

raport. Raporti vazhdon duke shtuar se "Të drejtat e pronës mbeten një sfidë tjetër në Shqipëri, pasi titulli i qartë është i vështirë për t'u marrë. Disa faktorë përfshijnë aktorë të paskrupullt që manipulojnë sistemin e korrupsionit të gjykatave për ta fituar titullin e pronësisë në një tokë që nuk është e tyre. Kompensimi për tokën e konfiskuar nga regjimi i mëparshëm komunist është i vështirë për t'u marrë dhe i papërshtatshëm. Ndërkohë, agjencia e ngarkuar me çështjen e ndërtesave të ndërtuara në mënyrë të paligjshme shpesh vepron pa konsultime të plota dhe nuk ndjek procedurat". Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit për klimën e investimeve është një publikim periodik që merr në analizë klimën e investimeve në 170 ekonomi duke mundësuar kështu informacion në shërbim të biznesit. Materialet që përgatiten nga ekonomistët e akredituar brenda ambasadave në vende të ndryshme të botës duke analizuar ekonomitë që mund të shihen si tregje potenciale nga bizneset amerikane.

Limaj optimist se partitë do të bëhen bashkë për fazën finale me Serbinë



PRISHTINË, 31 KORRIK - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, ka pritur të martën në takim kryetarin e Partisë Demokratike Shqiptare, Ragmi Mustafa, me të cilin ka diskutuar për gjendjen e shqiptarëve që jetojnë atje. Zëvendëskryeministri Limaj është zotuar se institucionet e Kosovës do t'u qëndrojnë afër dhe do t'i mbështesin gjithmonë qytetarët e Luginës së Preshevës. Sa i përket dialogut me Serbinë, zëvendëskryeministri Limaj ka thënë se në çaste vendimtare klasa politike në Kosovë duhet të bëhet bashkë. "Ne mund të kemi qëndrime të ndryshme për sa u takon politikave ditore, por në tema nacionale ne do të jemi bashkë", ka thënë Limaj. Ai ka

thënë se si institucione të Kosovës do të jenë në kontakt të vazhdueshëm me përfaqësuesit e Luginës dhe angazhohen që banorët e Luginës së Preshevës t'i gëzojnë të drejtat që u takojnë. Ndërsa kryetari i Partisë Demokratike Shqiptare, Ragmi Mustafa, ka thënë se shqiptarët e Luginës së Preshevës po kërkojnë bashkim me Kosovën. Mustafa ka thënë se Lugina po kërkon që çështja e shqiptarëve në Luginën e Preshevës të përfshihet në fazën finale të bisedimeve në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Kërkojmë nga institucionet e Kosovës të merren me statusin politik të qytetarëve të Luginës. Lugina nuk bën të lihet anash", ka thënë Mustafa.

Franca nderon Mimi Kodhelin me titullin e lartë

Tiranë, 31 korrik - Mimi Kodheli është nderuar nga presidenti i Francës, Emmanuel Macron, me titullin "Kalorës i Urdhrit Kombëtar të Legjionit të Nderit".

Dekorata i është dorëzuar nga ambasadorja e Francës në Shqipëri, Christina Vasak. "Falënderoj presidentin Emmanuel Macron që më nderoi

me titullin e lartë të Republikës së Francës, 'Kalorës i Urdhrit Kombëtar të Legjionit të Nderit'. U jam mirënjohëse të gjithë atyre që bënë të mundur marrjen e

këtij titulli. Faleminderit kujtdo që ka kontribuar sadopak për bërjen të mundur të këtij nderimi", ka shkruar Mimi Kodheli në "Facebook".



Kosova, optimiste se liberalizimi i vizave do të përmbillet këtë vit

Pavarësisht prej vështirësive, përfaqësuesit e institucioneve shtetërore kanë shprehur optimizëm se këtë vit do të përmbillet procesi i liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. Sipas tyre, tash e tutje Kosovës i mbetet të dëshmojë para shteteve anëtare të BE-së se po e lufton korrupsionin dhe se nuk ka numër të rritur të azilkërkuesve në vendet e BE-së

EPOKA E RE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 31 KORRIK - Dhënia e rekomandimit për heqjen e vizave nga Komisioni Evropian ka bërë që liderët shtetërorë të besojnë fuqishëm se gjatë këtij vitit do të përfundojë procesi i liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. Në këtë kontekst, presidenti i Republikës Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se brenda tre-katër muajve do të përmbillet ky proces. Edhe kryeparlamentari Kadri Veseli dhe kryeministri Ramush Haradinaj kanë thënë se liberalizimi do të jetë proces i pandashëm. Ata kanë bërë me dije se institucioneve të Kosovës u mbetet të punojnë edhe më shumë për zbatimin e reformave si dhe për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit në mënyrë që të mos shkaktohen vonesa të tjera në kuadër të liberalizimit të vizave.

Edhe kryetarja e Komisionit për Integritet Evropian në Kuvendin e Kosovës, Blerta Deliu-Kodra, ka thënë se procesi i liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës do të përfundojë këtë vit. Ajo ka bërë me dije për gazetën "Epoka e re" se aprovimi

i rekomandimit për vizat do të jetë më i lehtë në Parlamentin Evropian, ndërsa më kompleks në Këshillin e Ministrave. "Dhënia e një date të saktë për këtë proces do të ishte një paragjykim i vendimmarrjes së dy institucioneve të Bashkimit Evropian, pasi ky proces është i tëri vullnet politik i anëtarëve të Parlamentit Evropian dhe përfaqësuesve të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian. Por, bazuar në përmbushjen e të gjitha kriterëve dhe bazuar në takimet tona të ndryshme që kemi pasur me përfaqësues të institucioneve të BE-së, shpresojmë se ky proces të përfundojë gjatë këtij viti", ka deklaruar Deliu-Kodra. Ajo ka paralajmëruar se institucionet e Kosovës do ta kenë një dinamikë të re të lobimit për liberalizimin e vizave për t'i bindur vendet anëtare të BE-së se janë plotësuar kushtet dhe se kosovarët nuk do ta keqpërdorin liberalizimin. "Pra, puna, përpjekjet tona dhe mobilizimi vazhdojnë edhe pas rekomandimit pozitiv nga Komisioni Evropian. Më lejoni ta quaj në zhargonin futbollistik, tashmë jemi në finale, ku më shumë se kurrë ne duhet të jemi më dinamikë në procesin e lobimit dhe prezantimit të punës



sonë tek të gjithë aktorët e procesit vendimmarrës. Prandaj komisioni do të ketë edhe një dinamikë të re të lobimit edhe në këtë fazë. Përveç kësaj, institucionet tona duhet ta vazhdojnë kampanjën për vetëdijësimin e qytetarëve me të drejtat dhe përgjegjësit nga procesi i liberalizimit", është shprehur Deliu-Kodra, duke shtuar se Kuvendi ka prioritet kombëtar agjendën e integritetve evropiane. "Bazuar në këtë prioritet të përbashkët kombëtar, nuk e shoh si problem apo nuk do të duhej të ishte problem konsensusi kombëtar sa iu përket temave që ndërlidhen me agjendën e integritetve evropiane. Agjenda evropiane ndërthen në vete edhe miratimin e legjislacionit që drejtpërdrejt ndërlidhet me këtë agjendë dhe mosmiratimi i këtyre ligjeve do ta ngadalësonte

dinamikën e procesit të integritetve evropian", ka theksuar ajo. Ish-ministrja e Integritet Evropian, Mimoza Ahmetaj, ka shprehur optimizëm se procesi i liberalizimit të vizave do të përmbillet këtë vit. Megjithatë, ajo ka thënë se Kosovës i mbetet të dëshmojë para shteteve anëtare të BE-së se po e lufton korrupsionin dhe se nuk ka numër të rritur të azilkërkuesve në vendet e BE-së. "Për procesin e liberalizimit të vizave jam optimiste që si proces brenda institucioneve të Bashkimit Evropian (BE) do të përmbillet këtë vit. Kosova duhet të dëshmojë para shteteve anëtare se është duke punuar në vazhdimësi në luftimin e korrupsionit. Duhet të dëshmojë se i ka përmbushur të gjitha kriteret për lëvizje të lirë si dhe duhet të dëshmojë se nuk ka numër të rritur të azilkërkuesve në vendet e

Bashkimit Evropian", ka deklaruar Ahmetaj për gazetën "Epoka e re". Ajo u ka bërë thirrje institucioneve ta shtojnë angazhimin për t'i përfunduar reformat e domosdoshme në mënyrë që shteti i Kosovës të avancojë në procesin e integritetve evropian. Sipas Ahmetajt, ky proces duhet të mbetet prioritet dhe, si i tillë, kërkon konsensus politik. "Procesi i integritetve evropian duhet të mbetet prioritet për institucionet e Republikës së Kosovës, prandaj në vazhdimësi duhet të shtohet puna drejt përmbushjes së këtyre kriterëve apo bërjes së reformave të domosdoshme, në mënyrë që shteti ynë të avancojë në këtë agjendë/proces. Integritetve evropian është proces që i takon edhe pozitës, edhe opozitës, prandaj për këtë proces është shumë me rëndësi të ketë konsensus politik", është shprehur Ahmetaj.

Shtatore, autostradë e park me emrin e Demaçit

PRISHTINË, 31 KORRIK - Me vendimin e miratuar nga Qeveria e Kosovës është formuar komisioni për vendosjen e shtatores së Adem Demaçit në Sheshin "Adem Demaçi" në Prishtinë, për emërtimin e autostradës Prishtinë - Pejë "Autostrada Adem Demaçi" dhe propozimin për të emërtuar Parkun e Qytetit të Prishtinës - "Parku Adem Demaçi". Komisioni ka për obligim t'i fillojë procedurat për shpalljen e konkursit, përzgjedhjen,

rregullimin e hapësirës në lokacionin Sheshi "Adem Demaçi" si dhe mbikëqyrjen e zhvillimit të punëve deri në vendosjen e shtatores. Po ashtu, ky komision ka për obligim t'i fillojë procedurat e emërtimit të autostradës Prishtinë - Pejë "Autostrada Adem Demaçi". Komisioni ka për obligim ta përgatisë propozimin për emërtimin e Parkut të Qytetit "Parku Adem Demaçi" dhe procedimin e të njëjtit në Komunën e Prishtinës.



PRESIDENTI I KOSOVËS, HASHIM THAÇI, KA MBAJTUR KONFERENCË PËR MEDIE LIDHUR ME ECURINË E PROCESIT TË DIALOGUT KOSOVË - SERBI

Thaçi: S'ka forcë që na detyron të diskutojmë për ndarjen e Kosovës

Presidenti Hashim Thaçi i ka siguruar qytetarët se nuk do të ketë forcë që do ta detyrojë Kosovën të diskutojë, e lëre më të pajtohet me ndarjen e saj. Ai ka premtuar se kjo çështje nuk do të jetë pjesë e agjendës së procesit të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Këto komente shefi i shtetit i ka bërë të martën në një konferencë me gazetarë, ku ka bërë me dije se nuk do të ketë as bosnjëzim të Kosovës dhe as Ahtisari+. Presidenti Thaçi ka kërkuar unitet nga faktori politik për fazën finale të dialogut me Serbinë, duke u bërë thirrje partive politike t'i lënë anash interesat personale e partiake dhe të rreshtohen në shërbim të interesave të shtetit dhe të qytetarëve

**EPOKA
ERE** Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 31 KORRIK - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë të martën se nuk do të ketë forcë që do ta detyrojë palën e Kosovës të flasë për ndarjen e Kosovës në kuadër të procesit të dialogut me Serbinë. Ai ka bërë me dije se nuk do të ketë bosnjëzim të Kosovës, nuk do të ketë Ahtisari+ si dhe nuk do të ketë ndarje të Kosovës. "Si

president i vendit edhe një herë i siguroj qytetarët e Kosovës se nuk do të ketë forcë që do ta detyrojë Kosovën të diskutojë, e lëre më të pajtohet me ndarjen e saj. Nuk do të lejojmë as të diskutohet e lëre më që dikush të pajtohet me ndarjen e Kosovës. Janë shqetësues zërat që flasin gjëra të tilla, kur me të vërtetë gjërat e tilla po kalojnë së përfoluri edhe nga njerëzit që kanë legalitet edhe në institucionet e vendit. Nuk do të ketë

bosnjëzim të Kosovës, nuk do të ketë ndarje të Kosovës, nuk do të ketë Ahtisari+", ka deklaruar Thaçi në një konferencë me gazetarë.

Presidenti Thaçi e ka quajtur dëshpëruese që Kuvendi i Kosovës nuk ka arritur të dalë me një dokument në fund të debatit për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Megjithatë, ai ka thënë se roli i Kuvendit në procesin e dialogut është i pazëvendësueshëm.

"Është jashtëzakonisht inkurajues debati në Kuvend, por është dëshpëruese që Kuvendi nuk arriti t'i kalojë divergjencat e interesave personale e partiake për të nxjerrë një dokument në interes të shtetit. Kuvendi si institucioni më i lartë miraton apo refuzon si dhe jep fjalën e fundit për marrëveshjen eventuale, në këtë rast në mes të Kosovës dhe Serbisë. Roli i Kuvendit është i pazëvendësueshëm, por pushtetet janë të

ndara. Dhe në asnjë rrethanë nuk mund të mbesim peng i interesave ditore politike të një





Foggo: NATO-ja e gatshme ta ruajë sigurinë e Kosovës

Admirali amerikan James Foggo, komandant i Komandës së Forcave të Bashkuara Aleate në Napoli, i cili ka vizituar të martën bazën ushtarake të KFOR-it, Nothing Hill, në afërsi të Leposaviqit, ka thënë se NATO-ja do të vazhdojë t'i përkrahë institucionet e Kosovës dhe të ofrojë siguri për qytetarët

PRISHTINË, 31 KORRIK - NATO-ja nuk dëshiron të përfshihet në bisedimet që po bëjnë Kosova dhe Serbia, por ushtarët e saj janë të gatshëm t'i përgjigjen çdo situatë në rast të eskalimeve eventuale. Kështu ka thënë një nga komandantët e NATO-s, James Foggo, i cili është duke qëndruar në Kosovë.

Admirali amerikan James Foggo, komandant i Komandës së Forcave të Bashkuara Aleate në Napoli, ka thënë se rreth 4 000 ushtarë të NATO-s janë të gatshëm për çdo gjë. "Nuk shoh asnjë kërcënim për integritetin e Kosovës", ka thënë Foggo në një konferencë për medie në bazën ushtarake të KFOR-it Nothing Hill në afërsi të Leposaviqit. "KFOR-i është shumë i fortë dhe ne nuk shohim ndonjë problem në të

ardhmen e afërt apo të largët", ka thënë ai.

I pyetur nga gazetarët rreth shkrimeve të vazhdueshme në media për opsionet e ndarjes së Kosovës, ai ka thënë se "këto janë pyetje politike që duhet të zgjidhen përmes dialogut Prishtinë - Beograd". Admirali Foggo ka thënë se diskutimet në Beograd mund të sjellin edhe protesta në rrugë, por ai u ka bërë thirrje të gjithëve që edhe në rast të pakënaqësive, ato të shprehen në mënyrë demokratike. "Çdo herë që ka diskutime për zgjidhje kontroverze politike për problemet në Ballkan, ka potencial për trazira. Rrjedhimisht, jemi të vetëdijshëm se kjo është një kohë e rëndësishme, se ka shumë diskutime përtej kufijve të Kosovës, siç thashë në mes të Prishtinës dhe Beogradit,

udhëheqësit politikë që përpiqen t'i zgjidhin disa çështje të vështira", ka theksuar ai, duke shtuar se në demokraci jo të gjithë pajtohen. "Disa njerëz i shprehin mosmarrëveshjet e tyre në rrugë. Unë do t'ju rekomandoja të mos e bëjnë këtë gjë ose, nëse veprojnë kështu, si në çdo demokraci të civilizuar, kjo gjë të bëhet në mënyrë paqësore. Ne do të jemi këtu për t'i mbështetur institucionet e Kosovës të cilat ruajnë sigurinë gjatë këtij muaji dhe muajve të tjerë të vitit", ka thënë admirali amerikan James Foggo. Forca shumëkombëshe e KFOR-it në Kosovë ka mision paqeruajtës. Misioni i KFOR-it buron nga Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit dhe Marrëveshja Ushtarake Teknike e Kumanovës.

individ, apo të një strukture politike", është shprehur Thaçi, duke kërkuar unitet nga faktori politik për fazën finale të dialogut me Serbinë. "Nuk kemi kohë për të humbur, kjo çështje nuk është e individëve, por si bartës të institucioneve dhe i gjithë spektri politik e ka për obligim të lëvizë më shpejt, ta shtyjë procesin përpara në mënyrë që të arrihet marrëveshja finale. Prandaj ftoj spektrin politik t'i lënë anash inatet personale e partiake dhe të rreshtohet në shërbim të shtetit dhe të interesave shtetërore. Nuk duhet të humbim këtë rast dhe këtë mundësi historike. Vonesat në arritjen e marrëveshjes finale janë në shërbim të ideologjive joperëndimore në Ballkanin Perëndimor. Duke u vonuar e rrezikojmë të ardhmen euroatlantike të Kosovës. Nuk mund ta mbajmë vendin të izoluar", ka theksuar Thaçi. Sipas tij, kërkesa e opozitës që njëherë të mbahen zgjedhjet parlamentare e pastaj të vazhdojë dialogu është e papranueshme. "Disa kërkojnë zgjedhje e pastaj thonë se duhet të ndodhë dialogu dhe marrëveshja. Një gjë e tillë është e papranueshme për partnerët e koalicionit të cilët e kanë shumicën në Kuvendin e Kosovës. Po ashtu, as bota nuk na pret neve të organizojmë zgjedhje, pastaj të vazhdohet dialogu.

Çfarë do të ndodhë që edhe pas zgjedhjeve sërish një pjesë e opozitës të shprehet kundër dialogut. Prandaj i ftoj partitë politike të ulen dhe t'i diskutojmë hapat e mëtutjeshëm të koordinuar. Me aq sa po shoh, më shumë ka tone elektorale se sa ndonjë hendek politik. Kam besim të plotë dhe ftoj që spektri politik të jetë unik për interesa të shtetit dhe t'i lënë interesat personale e partiake. Të marrim përgjegjësi të gjithë, por edhe të shpërndahen kreditë. Ata që nuk duan të marrin përgjegjësi nuk do t'i lejojmë të na japin moral", ka deklaruar Thaçi. Ai ka ripërsëritur se marrëveshja finale që pritet të arrihet në të ardhmen në mes të shtetit të Kosovës dhe shtetit të Serbisë, nënkupton njohje reciproke. Sipas Thaçit, me këtë marrëveshje Kosovës do t'i hapet mundësia të anëtarësohet në organizata ndërkom-bëtare. "Ne do të punojmë fuqishëm që marrëveshja finale në mes të Kosovës dhe Serbisë të jetë në përputhshmëri me vullnetin e qytetarëve. Shteti i Kosovës ka kuptim vetëm duke qenë pjesë e NATO-s dhe Bashkimit Evropian. Duhet të punojmë të gjithë së bashku në mënyrë që të marrim vendime që janë në interes jetik për të ardhmen e qytetarëve të Republikës së Kosovës", ka theksuar presidenti Thaçi.



Haradinaj pret në takim bashkatdhetarët, u premtun përkrahje

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 31 KORRIK - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, të martën ka takuar bashkatdhetarët që jetojnë dhe veprojnë në vende të ndryshme të Evropës, të cilët i ka falënderuar për kontributin e dhënë nëpër të gjitha etapat historike të shtetndërtimit të Kosovës.

Kryeministri tha se në kohët më të vështira të viteve '90 e gjithë Kosova ka jetuar prej tyre dhe çmoi lart kontributin e dhënë nga diaspora për lirinë e vendit. "Ndërtimin e lirisë, si një proces shumë i vështirë, ju e keni përkrahur, sidomos rimëkëmbjen e menjëhershme të pasluftës, kur Kosova ka qenë e shkatërruar dhe keni vazhduar ta përkrahni edhe më tutje", ka thënë kryeministri, duke veçuar anën financiare, si një gjë shumë të çmuar për Kosovën, e cila ka ndikuar në zhvillimin ekonomik të saj. Më tutje kryeministri Haradinaj

ka shtuar se gjëja më e çmuar është lidhja që bashkatdhetarët i bëjnë Kosovës me popujt ku jetojnë. "Është me rëndësi me dërgu porosi të mira", është shprehur Haradinaj, duke lutur bashkatdhetarët që këto lidhje me popujt e vendeve ku jetojnë t'i forcojnë edhe më tutje, duke u bërë shtetas të mirë të atyre vendeve ku jetojnë.

Duke përmendur faktin se Kosova është anëtare e shumë organizatave të ndryshme ndërkombëtare, qofshin ato sportive apo të fushave të tjera, kryeministri Haradinaj ka thënë se Kosova ka ende probleme që duhet t'i tejkalojë, por që po punon ngushtë me shtetet aleate të shtetndërtimit të saj.

Kryeministri porositi bashkatdhetarët të mos e harrojnë atdheun e tyre dhe ta ndihmojnë atë atje ku munden, duke premtuar se do të angazhohet për përmirësimin dhe zgjidhjen e shumë çështjeve që kanë të bëjnë me diasporën tonë dhe vendin. "Tani është koha që ne po merremi me tema të mëdha,



të cilat kanë mbetur pa u zgjidhur prej vitesh, siç është tema e ambientit. Në shtator do ta pastrojmë në mënyrë gjenerale Kosovën, Kosovën tonë, Kosovën

tuaj, siç do të merremi edhe me shumë çështje që e preokupojnë diasporën, veçmas kartoni i gjelbër", ka deklaruar kryeministri Haradinaj. Kryeministri ka zhvil-

luar bashkëbisedim me shumë prej përfaqësuesve nga diaspora, të cilët kanë marrë pjesë në pritjen e organizuar nga Zyra e Kryeministrit.

Kurti: Të zbatohet menjëherë rezoluta për Postën dhe Telekomin



PRISHTINË, 31 KORRIK - Rezoluta dymbëdhjetëpikëshe për daljen nga kriza e Postës dhe Telekomit, e cila është miratuar në Kuvendin e Kosovës, duhet të zbatohet menjëherë. Kështu kanë thënë të martën në një konferencë për medie përfaqësuesit e Lëvizjes Vetëvendosje. Ata kanë bërë thirrje që bordi aktual të hiqet në mënyrë që të emërohen njerëz profesionistë. Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë se është i domosdoshëm zbatimi i kësaj rezolute me qëllim që të zgjidhet problemi i Postës dhe Telekomit. "Siç e dimë të gjithë, në Kuvend është miratuar një rezolutë për ta shpëtuar dhe mbrojtur Telekomin. Një rezolutë me 12 pika të cilat e tregojnë shtegun se si Telekomit të dalë nga kriza. Miratimi i kësaj rezolute ishte fitore e madhe për të gjithë republikën. Në bazë të asaj rezo-

lute ne kërkonim të tërhiqen anëtarët aktualë të bordit të emëruar dhe të punësohen njerëz me përvojë, që Qeveria të tërhiqet nga marrëveshja abuzive me drejtorin e Telekomit për marrëveshjen me 'Z mobile'. Sot e kësaj dite kjo Qeveri nuk ka ndërmarrë asnjë hap, prandaj jemi këtu në mbrojtje të vendimit të Kuvendit", ka thënë Kurti.

Profesor Salem Lepaja ka thënë se emërimi i Gent Begollit në krye të Telekomit do ta thellojë krizën edhe më tutje në këtë institucion. "LV-ja, siç e dini, e ka përcjellë krizën e rëndë në Telekom. Menjëherë pas emërimit të Gent Begollit kemi reaguar, sepse është emëruar një person jokompetent", ka thënë Lepaja, duke shtuar se janë bërë 20 ditë nga aprovimi i kësaj rezolute dhe ende nuk ka filluar zbatimi i saj.

Gentiana Begolli zgjedhet kryetare e AGK-së

PRISHTINË, 31 KORRIK - Gazetarja e "RTK"-së, Gentiana Begolli, është zgjedhur kryetare e re e Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës (AGK). Ajo ka fituar në garën përballë dy kundërkandidatëve, Fitim Gashit nga gazeta "Koha ditore" dhe

Alban Selimit nga "RTK"-ja. Gazetarja Begolli ka marrë 97 vota nga kolegët gazetarë. AGK-ja me këtë rast ka zgjedhur edhe bordin e ri të anëtarëve në një kuvend të jashtëzakonshëm që është mbajtur të martën. Të

regjistruar si pjesëmarrës në kuvendin e jashtëzakonshëm zgjedhor të AGK-së ishin 277 anëtarë, ndërsa në votim kanë marrë pjesë 239 anëtarë, ku 237 fletëvotime ishin të vlefshme, ndërsa 2 fletëvotime ishin të pavlefshme.



Publikohet raporti final "Tregtimi i shëndetit publik për përfitime private"

KDI-ja: Kapja e shtetit në Kosovë përmes sektorit të shëndetësisë



Drejtori ekzekutiv i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu, ka theksuar se në këtë raport janë analizuar dhe vlerësuar disa segmente në sektorin e shëndetësisë që ofrojnë dëshmi se si firmat private ushtrojnë ndikim tek institucionet shtetërore për përfitime private

EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 31 KORRIK - Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) në një tryezë diskutimi si pjesë e programit rajonal "Kapja e shtetit në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe Turqi", i cili zbatohet nga rrjeti global Transparency International, ka publikuar raportin final "Tregtimi i shëndetit publik për përfitime private". Në hapje të kësaj tryeze, drejtori ekzekutiv i KDI-së, Ismet Kryeziu, ka theksuar se në këtë raport janë anal-

izuar dhe vlerësuar disa segmente në sektorin e shëndetësisë që ofrojnë dëshmi se si firmat private ushtrojnë ndikim tek institucionet shtetërore për përfitime private dhe se si këto institucione ndikojnë tek firmat dhe për pasojë i shkaktojnë dëme të konsiderueshme shoqërisë sonë.

Mona Niemeyer, koordinatore e programit në Sekretariatit e Transparency International në Berlin, ka theksuar se edhe strategjia e re e Komisionit Evropian për zgjerim, konfirmon se shtetet e Ballkanit

shfaqin elemente të shtetit të kapur dhe se të njëjtat duhet ta luftojnë pa kompromis korrupsionin dhe se, sipas saj, kjo mund të arrihet nëpërmjet dy qasjeve, në njërin anë duke fuqizuar mekanizmat e sanksionimit, nga ana tjetër nëpërmjet ngritjes së aktpadive. Niemeyer ka shtuar se kohët e fundit është përdorur koncepti i ashtuquajtur "kapja e shtetit" që, sipas saj, nënkupton momentin kur vendimet politike orientohen larg nga interesat e sektorit publik përmes mjeteve korruptive.

Ndërkaq Arben Kelmendi, menaxher i programit Kundër Korrupsionit në KDI, ka prezantuar gjetjet dhe rekomandimet e dala nga raporti "Tregtimi i shëndetit publik për përfitime private". Ai ka thënë se raporti përpiket të argumentojë se kapja e shtetit në Kosovë po ndodh duke identifikuar praninë e saj në

dimensione të veçanta të sistemit publik të kujdesit shëndetësor publik. Kelmendi ka theksuar se ekziston një tendencë e përgjithshme e këtij sistemi për t'i orientuar njerëzit drejt operatorëve privatë si rezultat i së cilës ata detyrohen të paguajnë më shtrenjtë shërbimet dhe produktet mjekësore. "Mekanizmat specifikë të asaj se si bëhet kjo janë ilustruar në këtë raport nëpërmjet një shqyrtimi të proceseve specifike, përkatësisht një rast specifik i referimeve nga institucionet publike të kujdesit shëndetësor tek operatorët privatë dhe praktikat e prokurimit publik të medikamenteve dhe furnizimeve mjekësore, gjë që shkakton furnizim të pamjaftueshëm në institucionet publike të kujdesit shëndetësor dhe i detyron qytetarët të blejnë privatisht", ka bërë me dije ai.

Bazuar në gjetjet e dala nga ky raport, Kelmendi ka thënë se

rekomandohet të ulet ndikimi politik dhe komercial në Ministrinë e Shëndetësisë dhe në institucionet e tjera përgjegjëse për shëndetin publik, të zgjidhen problemet e shumta që lidhen me prokurimin e barnave dhe furnizimeve mjekësore që redukton disponueshmërinë dhe cilësinë e tyre. Po ashtu, të forcohen mekanizmat për identifikimin, parandalimin dhe raportimin e shkeljeve të dispozitave ligjore nga ofruesit e kujdesit shëndetësorë, të përkrahet ngritja e kapaciteteve teknike të prokurorisë për trajtimin e rasteve mjekësore, të rritet transparenca në lidhje me financimin e fushatës në kuptimin që lidhjet specifike midis furnizuesve privatë të barnave, shërbimeve shëndetësore si dhe partive politike duhet të bëhen më të qarta si dhe të shfrytëzohen zotimet karshi integritetit në BE që t'u bëhet presion elitave politike drejt reformave.

Kërkohet siguri për institucionet financiare

PRISHTINË, 31 KORRIK (ER) - Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, ka pritur të martën në takim njoftues drejtorin ekzekutiv të Shoqatës së Bankave në Kosovë, Petrit Balija. Në këtë takim u bisedua për çështjet e sigurisë që ndërliken me institucionet financiare që

veprojnë në Kosovë. Me këtë rast, ministri Gashi u zotua se Task Forca e krijuar për ofrimin e sigurisë së institucioneve financiare do të ndërmarrë veprime konkrete që u mundësojnë këtyre institucioneve funksionimin e duhur. Ndërsa Balija ka kërkuar që ky bashkëpunim të vazhdojë

edhe në të ardhmen në mënyrë që të ketë zgjidhje të problemeve të sigurisë në institucionet financiare në përgjithësi. Në fund të takimit të dyja palët u pajtuan për bashkëpunim të mëtejshëm për zgjidhjen e problemeve, sidomos në fushën e sigurisë kibernetike dhe asaj fizike.



Qeveria shfuqizon vendimin për pemët, perimet dhe qumështin

PRISHTINË, 31 KORRIK (ER) - Kabineti qeveritar në mbledhjen e së martës ka miratuar vendimin për shfuqizimin e vendimit 02/57 të datës 17. 7. 2018 që obligon Doganën e Kosovës për zbatim të vendimeve të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për vendosjen e masës së përkohshme mbrojtëse në importin e pemëve, perimeve dhe për importin e qumështit me origjinë nga Bosnjë dhe Hercegovina.

Lidhur me këtë çështje kishte reaguar edhe Oda Ekonomike e Kosovës (OEK), pas një analize që i ka bërë vendimit të Qeverisë së Kosovës për ngritjen e taksës doganore deri në 30 për qind për prodhimet bujqësore që hyjnë në Kosovë, e cila pati konstatuar se kjo masë e ka çrregulluar tregun vendor. "Vendimi për aplikimin e masës mbrojtëse për pemë dhe perime jo vetëm se e ka çrregulluar tregun vendor, por ka ndikuar drejtpërdrejt edhe

në çmimin final të produkteve për kompanitë përpunuese dhe tregtare, lënda e parë e të cilave bie në kategorinë e produkteve të mbrojtura", thuhet në analizën që ka bërë OEK-u. Me këtë vendim, sipas OEK-ut, është vërejtur zvogëlim i marzhës së fitimit dhe sasisë së shitur, ndërsa shumica e bizneseve të industrisë kanë theksuar se nuk ka prodhim vendor të mjaftueshëm për t'i përmbushur nevojat e konsumatorëve për pemë dhe perime.



Shënon rënie numri i udhëtarëve me tren, rritet ai me aeroplanë



e dytë të vitit 2018 numri i pasagjerëve që kanë shfrytëzuar trenin si mjet udhëtimi është 37 mijë e që, krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar (TM2 2017), numri i udhëtarëve është zvogëluar për 34.90 %. Transporti i mallrave me tren në tremujorin e dytë të vitit 2018 është 96 mijë tonë që, krahasuar me periudhën e njëjte të vitit të kaluar (TM2 2017), ka ulje për 27.27 %. Kurse sa i përket numrit të fluturimeve në tremujorin e dytë të vitit 2018 ka pasur 1 957 fluturime ose 10.75 % më shumë se në tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar (TM2 2017). Numri i udhëtarëve që kanë shfrytëzuar aeroplanin si mjet transporti gjatë këtij tremujori është rreth 524 mijë e që, krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar (TM2 2017), ka rritje për 12.67 %. Bazuar në kërkesën e Eurostat-it, duke filluar nga ky tremujor (TM2 2018), publikimi ka pësuar disa ndryshime në pjesën e telekomunikimit, duke përfshirë të dhëna edhe nga operatorë të tjerë, në mënyrë që të mbulohen të gjitha shërbimet e telekomunikimit të ofruara në vendin tonë.

EPOKA E
A. MAVRAJ

PRISHTINË, 31 KORRIK - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka

publikuar "Statistikat e Transportit dhe Telekomunikimit" për TM2018, me të dhëna mbi Transportin Ajror, Hekurudhor, Rrugor dhe

Telekomunikimin. Në territorin e Kosovës janë gjithsejtë 333 kilometra binarë hekurudhorë për transport. Në hekurudhat e Kosovës qarkullojnë gjithsejtë

nëntë lokomotiva, prej tyre shtatë dizell dhe dy trena motorikë. Lokomotivat bartin dhjetë vagonë për udhëtarë dhe 1 420 vagonë për mallra. Në tremujorin

29 studentë nisin punën praktike në ATK

PRISHTINË, 31 KORRIK (ER) - Në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) nga data 1 gusht do ta nisin punën praktike 29 studentë. Ky është grupi i katër studentëve nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" të cilët janë përzgjedhur për angazhim në punë praktike në ATK, në bazë të memorandumit të bashkëpunimit në mes të Ministrisë së Financave dhe Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina". Studentët janë nga Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore, Fakulteti Juridik dhe

Fakulteti Ekonomik. "Ne do të vazhdojmë edhe më tutje t'i përkrahim studentët profesionalisht në mënyrë që të jenë të përgatitur për tregun e punës. Ajo çfarë do të mësoni nga Administrata Tatimore është një arritje e madhe për juve dhe karrierën tuaj, pasi ashtu siç e dini, ATK-ja është institucion i cili garanton stabilitet financiar në vend, me mjete që grumbullojmë, qytetarëve u mundësohet një mirëqenie më e mirë", ka thënë drejtori i Administratës Tatimore të Kosovës, Sakip Imeri.



Themelohet grupi punues për vlerësimin e aseteve të 'Trepçës'

EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 31 KORRIK - Qeveria e Kosovës në mbledhjen e së martës ka themeluar grupin punues teknik për vlerësimin e të gjitha aseteve që janë në pronësi të ndërmarrjes shoqërore "Trepça" Sh. A. dhe përfshirja e të gjitha aseteve fizibile në statutin e shoqërisë aksionare "Trepça" Sh. A. Grupi do të ketë përbërje: Ministria e Zhvillimit Ekonomik - dy përfaqësues, Zyra e Kryeministrit -

një përfaqësues, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale - një përfaqësues, Bordi i Trepçës - një përfaqësues, Menaxhmenti i Trepçës - një përfaqësues, Sindikata e Trepçës - dy përfaqësues, ekspert i pavarur - një përfaqësues.

Grupi do ta përgatisë propozimin final për Qeverinë jo më larg se tre muaj pas miratimit të këtij vendimi. Qeveria ka themeluar edhe grupin punues teknik për trajtimin dhe ofrimin e zgjidhjeve për të gjitha çësht-

jet sociale të ngritura nga Sindikata e Minatorëve të "Trepçës".

Kabineti qeveritar ka miratuar vendimin për shfuqizimin e vendimit 02/57 të datës 17. 7. 2018 që obligon Doganën e Kosovës për zbatim të vendimeve të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për vendosjen e masës së përkohshme mbrojtëse në importin e pemëve, perimeve dhe për importin e qumështit me origjinë nga Bosnjë dhe Hercegovina. Gjithashtu, është

shfuqizuar edhe vendimi 15/58 i datës 24. 7. 2018 për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit 02/57 të datës 17. 7. 2018.

Qeveria ka miratuar propozimin e Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike për negocimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit në fushën e diasporës ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Edhe propozimi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale ka marrë miratimin e kabinetit

qeveritar për nismën e lidhjes së Marrëveshjes për sigurime sociale në mes të Mbretërisë së Holandës dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës. Po ashtu, është aprovuar edhe vendimi për rritjen e numrit të stafit me katër inspektorë, në Drejtorinë e Inspeksionit në Komunën e Obiliqit, me qëllim të administrimit dhe kontrollimit të investimeve (ndërtimeve) në sektorin e ndërtimit dhe mjedisit në Komunën e Obiliqit, përkatësisht në Zonën e Interesit të Veçantë Ekonomik.



AKP-ja miraton listën për shitjen e 44 aseteve

PRISHTINË, 31 KORRIK (ER) - Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) ka mbajtur mbledhjen e rregullt (më 25 korrik) në të cilën ka shqyrtuar dhe miratuar listën e valës së shitjes së aseteve me likuidim 41, valë kjo që përfshin 44 asete atraktive në Kosovë. Po ashtu, Bordi i AKP-së ka miratuar edhe udhëzuesin e brendshëm për procedurat e parcelizimit të aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore, procedurë kjo tejet e rëndësishme gjatë përgatitjes së këtyre parcelave për procesin e shitjes me privatizim/likuidim si dhe rastet e tjera të transformimit të pronësisë të paraparë me Ligjin



e AKP-së. "Gjatë kësaj mbledhjeje Bordi aprovoi disa qiradhënie të aseteve të ndër-

marrjeve shoqërore në administrim direkt dhe atyre në likuidim. Në këtë mbledhje u

aprovua shpërndarja e mjeteve për kreditorët të NSh-ve në likuidim: GJ1058 Fabrika e

Baterive, PRZ004 Sillos dhe PRZ014 Ballkan në shumën prej 1,496,135.45 . Bordi, po ashtu, është njoftuar që 17 raportet përfundimtare të NSh-ve në likuidim do të dërgohen në DhPGJS dhe pas vendimit të Dhomës likuidimi i atyre ndërmarrjeve do të marrë fund. Bordi, po ashtu, aprovoi raportin me gjithsejtë 14 raste të komisionit për shitjen e banesave në pronësi shoqërore", është bërë me dije në njoftimin e AKP-së. AKP-ja ka njoftuar se me kohë do t'i njoftojë palët për vendimet e marra në mbledhjen e Bordit, ndërkaq mbledhja e radhës do të mbahet më 30 gusht.

Nis kampanja vetëdijësuese për kujdes gjatë vozitjes

PRISHTINË, 31 KORRIK (ER) - Ka filluar realizimi i kampanjës vetëdijësuese kundër përdorimit të telefonave gjatë vozitjes e cila shërben si një thirrje e radhës për ngasësit e automjeteve që të kenë kujdes të shtuar gjatë vozitjes.

"EC Ma Ndryshe" ka organizuar Shkollën e Aktivizmit me nxënës të shkollave të mesme nga ku edhe ka dalë si shqetësim përdorimi i telefonave nga ngasësit gjatë vozitjes, duke cenuar sigurinë në trafik.

Si rrjedhojë e kësaj ka dalë edhe ideja për realizimin e kësaj kampanje vetëdijësuese nga nxënësja Kleita Koci për kujdes të shtuar gjatë vozitjes.

Ky aktivitet është organizuar në bashkëpunim me KVRL Gjakovë dhe qytetarët e qytetit të Gjakovës, me ç'rast është bërë shpërndarja e fletushkave që përmbajnë mesazhe sensibilizuese dhe statistika të aksidenteve që kanë ndodhur që nga viti 2017 në rajonin e Gjakovës dhe në tërë Kosovën.

Bazuar në statistikat e marra nga

Policia e Kosovës vërehet rënie në numrin e aksidenteve, por prapë numri i atyre me fatalitet në trafik vazhdon të jetë shqetësues. Në rajonin e Gjakovës gjatë vitit 2017 kanë ndodhur gjithsej 1 094 aksidente, 11 prej tyre kanë përfunduar me fatalitet me 14 persona të vdekur, ndërsa në periudhën janar-qershor 2018 kanë ndodhur 372 aksidente, 4 prej tyre fatale me 4 persona të vdekur. Sa i përket territorit të Kosovës gjatë vitit 2017 kanë ndodhur gjithsej 17 695 aksidente, ku 122 prej tyre kanë qenë fatale dhe kanë rezultuar me 137 persona të vdekur.

Gjatë periudhës janar-qershor të këtij viti kanë ndodhur gjithsej 7 003 aksidente, ku 41 prej tyre kanë përfunduar me fatalitet dhe me 52 persona të vdekur. Kjo kampanjë shërben si thirrje për vozitësit që ta shtojnë kujdesin në trafik duke mos përdorur telefonat, duke respektuar rregullat e komunikacionit, ta vendosin rripin e sigurisë dhe ta përshtatin shpejtësinë sipas shenjave të urdhrave të



prera. Në krahasim me vitin e kaluar vërehet rënie në numrin e aksidenteve të trafikut, ndërsa rritje

në numrin e tiktave të shqiptuara, andaj edhe ky aktivitet shërben edhe si një thirrje ndaj institucion-

eve që të vazhdojnë të ndërmarin hapa konkretë për shtimin e sigurisë në komunikacion.

Zyrtarë të lartë komunalë të Mitrovicës biseduan me banorët e Mazhiqit



MITROVICË, 31 KORRIK (ER) - Zyrtarët e lartë komunalë të Mitrovicës kanë vazhduar komunikimin e drejtpërdrejtë me qytetarë, me qëllim të identifikimit të problemeve dhe nevojave të tyre, në mënyrë që pastaj të koordinohen aktivitetet për zgjidhjen e tyre. Një takim të tillë e kanë mbajtur me qytetarët e Mazhiqit të Shalës së Bajgorës,

drejtoresha për Integritet Evropian dhe Mirëqenie Sociale, Nazan Kërveshi dhe drejtori i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ekrem Sadiku. Në takimin me qytetarë në Mazhiq zyrtarët e lartë komunalë fillimisht janë njoftuar për gjendjen aktuale atje nga kryetari i fshatit, Kushtrim Zeneli. Ai dhe diskutuesit e tjerë

u kanë thënë drejtorëve Kërveshi dhe Sadiku, se në fshat aktualisht janë 40 shtëpi me rreth 200 banorë dhe se problemet sociale janë shqetësuese për ta. Banorët kanë kërkuar që komuna t'i përcjellë këto shqetësime tek drejtuesit e drejtorive përkatëse në Ministrinë e Punës dhe të Mirëqenies Sociale për t'i zgjidhur këto probleme.

Prishtina me shërbim të veçantë për grumbullim të mbeturinave në raste të renovimeve

PRISHTINË, 31 KORRIK (ER) - Komuna e Prishtinës ka njoftuar se Rregullorja për Menaxhimin e Mbeturinave, në Shtojcën A, parasheh tarifën për shërbimet e caktuara. Në kuadër të kësaj janë caktuar edhe vlerat që duhet të paguajnë konsumatorët me kontrata të veçanta, e që janë 10.5 euro për kontejnerin me vëllim 1.1 metër kub dhe 40.8 euro për kontejnerin me vëllim 7.1 metër kub. Këto kontrata të veçanta shërbejnë edhe për

largimin e mbeturinave të vëllimshme, në rastet kur qytetarët ose bizneset bëjnë renovime të shtëpive, të banesave apo lokaleve të tyre. "Mbeturinat nga renovimet, mos i hidhni pranë kontejnerëve të lagjes! Shfrytëzoni shërbimin që e ofron Komuna dhe Kompania 'Pastrimi', ashtu që të kontribuojmë të gjithë për një Prishtinë sa më të pastër", është bërë me dije në njoftimin e Komunes së Prishtinës.



Lladrovci e Ermira Zhuri, marrëveshje për financim të studentëve

DRENAS, 31 KORRIK (ER) - Në kuadër të bashkëpunimit në mes të Komunës së Drenasit dhe avokates Ermira Zhuri me seli në Treviso të Italisë është arritur marrëveshje bashkëpunimi për

financimin e bursave për katër studentë të Komunës së Drenasit, bëhet me dije përmes një komunikate për media. "Në kuadër të kësaj marrëveshje, avokatja Ermira Zhuri financon katër

bursa për studentët e Komunës së Drenasit për vitin akademik 2018-2019, ku vlera e një burse është 500 euro", thuhet në komunikatë. Komuna e Drenasit ka njoftuar se do të shpallë konkurs

për vitin akademik 2018-2019 dhe në bazë të kriterëve të konkursit do të përzgjidhen të gjithë përfituesit e bursave si nga komuna, po ashtu edhe nga donatorët.



Bisedimet me Serbinë të ndërpriten ose të ngrihen përkohësisht



Shyqyri HAXHA

Serbia prej vitit 1999 e deri më sot ka angazhuar tërë potencialin burimor njerëzor brenda dhe jashtë që ta 'ulë' në tavolinë të bisedimeve Kosovën dhe të bisedojë për çështje të brendshme të saj. Ajo në mënyrë të vazhdueshme ka insistuar që ta bindë bashkësinë ndërkombëtare që Kosova t'i nënshtrohet një procesi të quajtur 'bisedime teknike'.

Karta e bisedimeve 'teknike'

është 'Kali i Trojës' që sot përfundimisht e gjunjëzoi Kosovën t'i nënshtrohet një procesi shumë të padrejtë të bisedimeve që rrezikojnë tërësinë territoriale dhe vënë në pikëpyetje shtrirjen e shtetësisë së Kosovës në të gjithë territorin e saj.

Pala e Kosovës, si zakonisht asnjëherë, as në bisedime teknike, nuk angazhoi ekspertët më të zgjedhur të saj, përkundrazi në këto bisedime teknike kryesisht kanë marrë pjesë njerëz servilë të cilët janë të dëgjueshëm ndaj 'shefave'. Asnjë rezultat nga bisedimet teknike nuk doli të jetë në favor të shtetit të Kosovës. Të gjitha marrëveshjet, siç janë, p. sh., marrëveshja e country code-it, e energjisë, Ujmanit etj., pra asnjë marrëveshje e 'arritur' nuk ka qëndrueshmëri të një shteti të

pavarur. Të gjitha këto marrëveshje janë me bisht që nuk garantojnë shkëputje të plotë nga ndërhyrjet e mëtutjeshme të Serbisë.

Natyrisht se Serbia nuk do të heqë dorë nga minierat (Trepça). Pra, shtyllat kryesore të një shteti normal i ka 'dëmtuar' tejmase: Telekomini, energjinë, minierat, burimin e ujit etj. Një shtet që nuk ka nën kontroll të plotë këta sektorë kryesorë zhvillimorë do të dështojë që në fillim të ekzistencës së tij. Pra, sot Kosova nuk ka kontroll të plotë në asnjë sektor, as në tërësinë territoriale të saj. Të gjitha këto dështime kanë ndodhur si rezultat i mosangazhimit të njerëzve kompetentë (pra paaftësisë) dhe luftës për pushtet të lidërshiptonë. Për lidërshiptonë e Kosovës prior-

itet ka qenë lufta për të ardhur në pushtet dhe lufta që ta mbajnë pushtetin me çdo kusht. Kjo i ka kushtuar dhe do t'i kushtojë edhe më shumë Kosovës. Sot bisedimet me Serbinë janë duke ndodhur në një fazë shumë të rrezikshme për Kosovën. Bisedimet po ndodhin pikërisht në fazën kur ShBA-ja ka një Donald J. Trump president, që absolutisht ia ka huq me të madhe dhe Britania e Madhe ballafaqohet me një betejë jashtëzakonisht të vështirë siç është BREX-iti, e që as vetë nuk është duke e ditur se çfarë do të ndodhë me të. Pra, kur miqtë tanë kryesorë nuk janë në pozitë të favorshme për të na ndihmuar, e udhës do të ishte që bisedimet me Serbinë të ndërpriten apo të 'ngrihen' deri në një afat më të favorshëm për

Kosovën.

Serbisë po i nguten bisedimet me Kosovë pikërisht për arsyet e cekura më lart. Kosova do të duhej të pushojë pak, Kosova nuk duhet të bie pre e agjendës dhe strategjisë së Serbisë. Kosova nuk duhet të ngutet sepse ka kohë. Më mirë hiq të mos vazhdojnë bisedimet sesa të humbet territor apo ta cungohet shtetësia e vet apo që bisedimet të rezultojnë me fitoren e Pirros. Tekefundit, për çfarë bisedohet me Serbinë? Bisedohet për Kosovën dhe për minoritetin serb me Serbinë. Kjo nuk ka logjikë për një shtet të pavarur që të bisedojë për çështje të brendshme me një shtet tjetër. Atëherë zgjidhje do të ishte të bisedohet me lidërshiptonë serb të Kosovës dhe me garantues BE-në dhe ShBA-në.

Lideri i PLK-së, Skender Gashi, viziton pjesën veriore të Mitrovicës

MITROVICË, 31 KORRIK - Kryetari i Partisë Liberale të Kosovës (PLK), Skender Gashi, ka vizituar të martën Komunën e Mitrovicës së Veriut dhe atë të Jugut. Ai këtë vizitë e ka bërë me qëllim që të njoftohet nga afër me gjendjen në Mitrovicën e Veriut. Gjatë kësaj vizite Gashi ishte i shoqëruar edhe nga Imer Shabani. "Së bashku vizituam qytetin e pjesës veriore të Mitrovicës. Aty bisedova me qytetarë të kombësisë shqiptare dhe serbe. Pastaj shkuam te Gjykata Themelore e Mitrovicës, ku biseduam me policë të Republikës së Kosovës të kombësisë shqiptare dhe serbe. Me ta bisedova edhe rreth situatës dhe gjendjes në Komunën e Mitrovicës së Veriut. Sipas tyre, gjendja është e qetë dhe qytetarët janë të interesuar që kjo krizë të përfundojë sa më parë", ka thënë Gashi. Ai ka kërkuar nga presidenti Hashim



Thaçi dhe klasa politike që bisedimet me Serbinë të përfundojnë sa më parë.

Gashi ka bërë thirrje që në këtë proces të ketë unitet politik. "Z. Thaçi ta shfrytëzoj autoritetin e tij si president i Republikës së Kosovës me një unitet të të gjitha partive politike në Kosovë. Të gjendet gjuhë e përbashkët dhe të jemi unikë në zgjidhjen e kësaj çështje në bazë të ligjeve dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Qytetarët kanë mbetur peng të proceseve politike, të neglizhencës nga bashkësia evropiane dhe nga institucionet e Kosovës, ndërsa këto zgjatje të proceseve shkojnë në favor të Serbisë", është shprehur kreu i PLK-së.



Nëse injorohet Kosova Lindore, Kosova do të përballet me bllokadë

PRISHTINË, 31 KORRIK (ER) - Sekretari i përgjithshëm i Lëvizjes për Bashkim, Avni Klinaku, ka pritur të martën në takim kryetarin e Partisë Demokratike Shqiptare, Ragmi Mustafa. Në këtë takim u diskutua gjerësisht për zhvillimet e fundit lidhur me bisedimet Kosovë - Serbi, për zgjidhjen më të mirë për problemin shqiptaro-serb dhe gjendjen e rëndë të shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc e Medvegjë.

Klinaku në emër të Lëvizjes për Bashkim e ka mbështetur deklaratën e përbashkët të tri kuvendeve komunale të Kosovës Lindore përmes së cilës kërkohet përfaqësimi i shqiptarëve të kësaj treve në bisedimet Kosovë - Serbi. Sa i përket çështjes së pazgjidhur midis Kosovës e Serbisë, palët u pajtuan që hapi më i mirë drejt zgjidhjes është reciprociteti në të drejta midis banorëve të Leposaviqit, Zveçanit dhe Zubin Potokut dhe atyre të Preshevës, Bujanocit e Medvegjës deri në ridefinim të kufijve, si zgjidhje përfundimtare për problemin. Mustafa, duke shprehur mirënjohjen e tij për angazhimin e Lëvizjes për Bashkim për çështjen e shqiptarëve në Kosovën



Lindore, tha se kjo është qasja e duhur ndaj problemit. Përndryshe, në rast se injorohet çështja e Kosovës Lindore, për pasojë, Kosova do të përballet me bllokadë për shkak të një asociacioni të fuqishëm dhe fuqisë bllokuese të serbëve në

Kuvendin e Kosovës.

Ndërsa Klinaku u zotua se LB-ja do të angazhohet me tërë potencialin e vet në funksion të zgjidhjes së drejtë të këtij problemi dhe shprehu gatishmërinë për bashkëpunim në çdo aspekt.

Ish-shefi i fushatës Trumpit del para gjyqit

UASHINGTON, 31 KORRIK - Në Shtetet e Bashkuara të martën nisi gjyqi i ish-shefit të fushatës zgjedhore të presidentit amerikan, Donald Trump. Është ky gjyqi i parë nga hetimet që po bëhen për

ndërhyrjen e Rusisë në zgjedhjet presidenciale në ShBA më 2016.

Paul Manafort përballet me 18 akuza, përfshirë mashtrimin bankar dhe mund të përballet me 30 vjet

burgim nëse gjendet fajtor. Manafort, i cili e ka udhëhequr fushatën e Trumpit për tre muaj, nuk e ka pranuar fajësinë.

Përpara se t'i bashkohej ekipit të Trumpit në verën e vitit

2016, Manafort ka punuar për disa fushata presidenciale të republikanëve, përfshirë atë të Gerald Fordit në mes të viteve 1970 dhe të Ronald Reaganit nga viti 1978 deri më 1980.



Trumpi i gatshëm të takohet me Rohanin pa kushte

Presidenti Donald Trump tha se do të takohet me iranianët në çdo kohë që ata duan të takohen dhe pa kushte paraprake dhe se takimet janë të dobishme për zbutjen e tensioneve potencialisht të rrezikshme dhe se takimet e tij të fundit me udhëheqësin rus dhe atë të Koresë së Veriut ishin një shembull i mirë

Teheranin, duke paralajmëruar presidentin iranian që të mos kërcënojë kurrë më Shtetet e Bashkuara.

Çështja e Iranit u trajtua gjatë konferencës së përbashkët për shtyp mes presidentit Donald Trump me kryeministrin italian Giuseppe Conte. "Kryeministri pajtohet gjithashtu se regjimi brutal i Iranit nuk duhet të lejohet kurrë të ketë armë bërthamore. Kurrë! Ne i inkurajojmë të gjitha vendet t'i bëjnë presion Iranit për t'i dhënë fund të gjitha aktiviteteve të tij të rrezikshme. Shtetet e Bashkuara e mirëpresin partneritetin e

Italisë në këto përpjekje jetike", tha Trumpi.

Por i pyetur nëse do të ishte i gatshëm të takohet me presidentin iranian Hassan Rouhani, Trumpi tha se do të takohet me iranianët, në çdo kohë që ata duan të takohen dhe pa kushte paraprake. Ai tha se takimet janë të dobishme për zbutjen e tensioneve potencialisht të rrezikshme dhe se takimet e tij të fundit me udhëheqësin rus dhe atë të Koresë së Veriut ishin një shembull i mirë. "Sigurisht do të takohesh me udhëheqësit iranianë nëse ata do të donin të takoheshin, por nuk e

di nëse ata janë gati. Ata po kalojnë një periudhë të vështirë. Unë i dhashë fund marrëveshjes së Iranit. Ishte një marrëveshje qesharake. Besoj se në fund do të kërkojnë të takohen", tha ai. Zyrtarët në Teheran kanë përjashtuar mundësinë për bisedime me Uashingtonin, duke thënë se Shtetet e Bashkuara kanë treguar se nuk janë të besueshëm.

Mosmarrëveshjet mes Shtetet e Bashkuara dhe Iranit datojnë prej 1979-s që kur klerikët morën pushtetin në Teheran. Në muajin maj Trumpi nxiti sërish zemërimin e Iranit, me tërheqjen e Shtetet e Bashkuara nga marrëveshja bërthamore e arritur në vitin 2015 mes Iranit dhe gjashtë fuqive botërore. Ai ka bërë thirrje për një marrëveshje shumë më të ashpër që do ta kontrollonte sjelljen e Iranit në rajon si dhe çmontimin e programit të tij bërthamor.

Presidenti iranian paralajmëroi se politikat e Trumpit mund të çonin në atë që ai e cilësoi si "nëna e të gjitha luftërave", deklarata që shkaktoi një reagim të ashpër të Trumpit.

Por një general i lartë iranian tha se forcat e tij janë gati të përballen me çdo sfidë që vjen nga Trumpi. "I them Trumpit ta dijë që ne jemi aty pranë, ku ti nuk mund ta imagjinosh", tha Qassem Soleimani, komandant i Forcës Revolucionare.

Tani për tani Irani ka më shumë arsye për t'u shqetësuar për sanksionet ekonomike amerikane sesa për fuqinë e tij ushtarake. Sanksionet po i detyrojnë disa biznese të huaja të tërhiqen nga vendi, gjë që mund ta dëmtonte seriozisht ekonominë e Iranit.

UASHINGTON, 31 KORRIK - Presidenti amerikan Donald Trump bëri të ditur se është i gatshëm të takohet me udhëheqësit e Iranit "pa parakushte dhe në çdo kohë që ata duan".

Por, në një konferencë me gazetarë ai tha se "regjimi brutal" i Iranit nuk duhet të lejohet kurrë të disponojë armë bërthamore. Javën e kaluar Trumpi shkëmbu një retorikë të nxehtë me



Zaevi fton opozitën dhe qytetarët të dalin në referendum

SHKUP, 31 KORRIK - Kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev, ftoi qytetarët e vendit të tij të dalin në referendum dhe të votojnë "pro" marrëveshjes për emrin me Greqinë. "Të hënën Kuvendi konfirmoi datën për referendumin, ditë e cila është kyçe për të ardhmen tonë. Gjithë neve u është dhënë mundësia të vendosim për diçka të madhe. Kemi

treguar se jemi popull që mësojmë nga historia. Vota juaj është e drejta juaj, mos lejoni që dikush t'ju marrë dhe ta keqpërdorë. Ju ftoj të tregoni se askush nuk mund t'ju tregojë se çfarë të bëni. Do ta respektoj votën tuaj, sido që të jetë. Unë besoj në vendimin e qytetarëve dhe jam i bindur se Maqedonia do të bëhet anëtare e NATO-s



dhe BE-së, ndërsa populli maqedonas do të mbetet maqedonas dhe do të flasë maqedonisht", tha Zaevi.

Ai gjatë konferencës me gazetarë të martën ftoi edhe partinë opozitare maqedonase ta mbështesë referendumin dhe t'i ftojë qytetarët të marrin pjesë në referendum. "Opozita dëshiron ta shkatërrojë të ardhmen tonë. Ajo thotë se mund të arrijë marrëveshje më të mirë, por për këtë kishte 11 vjet. Ajo nego-

cioi në mënyrë sekrete dhe mbajti shtetin të robëruar. Është koha për vendime kyçe dhe historike e jo për ikje. U them sërish anëtarëve të VMRO-DPMNE-së, se dera edhe për ju është e hapur. Ju ftoj të gjithëve që të votoni me krenari dhe të themi 'po' për stabilitet dhe anëtarësim në NATO dhe BE", tha Zaevi.

Varroset aktori dhe regjisori Bekim Lumi

Familjarë, profesorë, studentë, artistë e politikanë dhe shumë qytetarë morën pjesë të martën në varrimin e aktorit dhe regjisorit Bekim Lumi, i cili tash e dy vjet është përballur me sëmundjen e kancerit

EPOKA E RE

Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 31 KORRIK - Miq, shokë dhe dashamirë u mbledhën të martën në Prishtinë për t'i dhënë lamtumirën e fundit regjisorit dhe profesorit të Arteve, Bekim Lumi. Ai ka ndërruar jetë të hënën në moshën 52-vjeçare, pas një sëmundje të rëndë me të cilën përballej tash e një kohë të

gjatë. Para se të bëhej ceremonia e varrimit u bënë homazhe dhe u mbajt një mbledhje përkujtimore. Në mbledhje u luajt një pjesë nga shfaqja e tij e fundit me emrin "Arturo Ui", të cilën e realizoi më 14 qershor në 20-vjetorin e krijimtarisë së tij artistike. Motra e të ndjerit, Drita Lumi, ka falënderuar të gjithë ata që kanë qenë pranë familjes në ditët e vështira nëpër të cilat kanë kalu-



ar. "Kur e shohim tanë këtë dhimbje dhe dashuri për Bekimin e kuptojmë sa të bekuar kemi qenë ne dhe ju me Bekimin. Disa prej jush patët fatin të jeni aktorë në shfaqjet skenike të Bekimit, kurse shumë e shumë të tjerë ishit aktorë të dramës jetësore dhe të çasteve shumë të vështira shëndetësore të Bekimit", ka thënë motra e të ndjerit.

Ajo shpreson se arti i Bekim Lumit do të jetë emblemë në skenën teatrore të Kosovës.

Pas mbledhjes varrimi i Lumit u bë në varrezat e qytetit ku kanë marrë pjesë shumë fytyra të njohura politike e artistike të vendit. Profetori në Fakultetin e Arteve, Fadil Hysaj, gjithashtu mik i regjisorit, ka potencuar se ajo

çfarë ka bërë Bekim Lumi për skenën shqiptare është frymëzim për shumë breza dhe se ai është themelues i post-avangardës shqiptare në teatër. "Bekim Lumi është themelues i post-avangardës shqiptare në teatër dhe, si i tillë, vërtet nuk ka një të dytë dhe ka për të kaluar shumë kohë që të vijë një pasardhës i tij në skenën shqipe", ka thënë Hysaj.

Ndërsa kryetari i Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka thënë se Lumi ka qenë një artist që ka zgjedhur të shprehet përmes artit dhe që ka shkaktuar debat në shoqëri. "Patjetër se është humbje e madhe që nuk është më në mesin tonë, megjithatë besoj se veprat e tij do të qëndrojnë edhe me vite të tëra, ndoshta

edhe me gjenerata që do të mësohen nga studentët. Prandaj i shpreh ngushëllim familjes dhe gjithë artistëve dhe shikuesve të artit", ka thënë Ahmeti.

Regjisori Bekim Lumi numëron dhjetëra shfaqje të realizuara e që kanë rezultuar të suksesshme. Ai u shpërblye me shumë çmime në Kosovë dhe jashtë saj. Në vitin 2016 ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve ia ndau çmimin për "Regjinë më të mirë". Në 20-vjetorin e krijimtarisë së tij artistike, regjisori Lumi më 14 qershor të këtij viti dha premierën e shfaqjes së tij të fundit "Arturo Ui", që erdhi në përvjetorin e 120 të lindjes së autorit të saj, Bertolt Brecht. Për shkak të sëmundjes, Lumi nuk mori pjesë në premierë të shfaqjes.

Qeveria miraton marrëveshjen për programin 'Evropa Kreative'

PRISHTINË, 31 KORRIK - Në mbledhjen e Qeverisë mbajtur të martën është miratuar marrëveshja e arritur në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrje të Kosovës në programin "Evropa Kreative", pas propozimit të ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, për ratifikimin e marrëveshjes.

Ministri në ekspozën e vet para kabinetit qeveritar ka arsyetuar se është i nevojshëm miratimi i marrëveshjes me qëllim të krijimit të kushteve më të mira për zhvillimin e kulturës në fushën ndërkombëtare. "Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit mbetet në vazhdimësi e përkushtuar të krijojë dhe të

zhvillojë politika të qëndrueshme në funksion të përbushjes së objektivave ligjore. Duke pasur parasysh këtë rëndësi të zhvillimit të kulturës, MKRS-ja ka nënshkruar Marrëveshjen Ndërkombëtare në mes të Kosovës dhe BE-së lidhur me pjesëmarrjen e Kosovës në programin 'Evropa Kreative' për sektorët kulturorë dhe kreativë", ka thënë ministri Gashi.

Po ashtu, ministri u shpreh se pjesëmarrja në këtë program do t'u mundësojë artistëve dhe profesionistëve të kulturës, si dhe organizatave krijuese, të punojnë së bashku dhe t'i bëjnë veprat e tyre krijuese për konkurrim me vendet e BE-së. Aprovimi i Projektligjit për




pjesëmarrje në kuadër të Programit "Evropa Kreative" njëherazi do të kontribuojë për forcimin e kapaciteteve të sek-

torit kulturor dhe krijues, përmes promovimit të platformave kulturore dhe përmirësimit të krijimeve evropiane kulturore,

dhe fuqizimit të audiencës, si dhe forcimit të inovacionit dhe krijimtarisë në fushën e kulturës. Gjithashtu, ndikim të veçantë do të ketë edhe në bashkëpunimin për rritjen e inovacionit, mobilitetit ndër-shtetëror dhe shkëmbimit të praktikave më të mira në fushën e kulturës.

Kostoja vjetore financiare që Kosova duhet t'i paguajë buxhetit të përgjithshëm të Bashkimit Evropian për të marrë pjesë në nënprogramin e kulturës dhe në fushat ndërsektoriale do të jetë 35 000 euro. Këtë shumë financiare Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e ka paraparë në buxhetin e saj dhe e njëjta do t'i procedohet BE-së sipas marrëveshjes.

Robert Pattinson në lidhje të re



Robert Pattinson ka një grua të re në jetën e tij. Ylli 32-vjeçar i Twilightit dhe modeluesja dhe aktorja 26-vjeçare Suki Waterhouse janë në lidhje dashurie, sipas një burimi të afërt

me të dy që ka folur për revistën "People". Ata janë parë në Londër gjatë fundjavës, ku edhe e kanë parë filmin "Mamma Mia! Here We Go Again" për të vazhduar më pas në një lokal nate.




Një ushtarë si Khloe

Ylli i mediave sociale, Khloe Kardashian, dukej 'e rrezikshme' në daljen e saj më të fundit në Los Angeles këtë të hënë. 34-vjeçarja mori vëmendjen me pantallonat e saj me motive

ushtrinë, e të cilat i kombinoi me take të verdha. Ajo këtë ditë e shfrytëzoi për xhirime bashkë me motrën Kourtney për episodet e reja të Keeping Up With The Kardashians.

Scarlett Johansson dhe i dashuri i saj në kërkim të një apartamenti milionësh



Scarlett Johansson dhe i dashuri i saj, komediani Colin Hanks, e kanë dërguar lidhjen e tyre në një nivel tjetër, pasi po planifikojnë të blejnë një apartament në Hamptons në vlerë prej 7.95 milionë dollarësh.

Me këtë hap synimi i tyre është fillimi i bashkëjetesës. Tani për tani ata kanë një apartament mahnitës me pesë dhoma gjumi në Gurney's në Montauk, që kushton 8.49 milionë dollarë.

78-vjeçari Tom Jones kthehet në skenë

Ai ka anuluar pesë koncerte në turneun e tij për shkak të problemeve shëndetësore derisa të gjashtin nuk mundi ta mbante për shkak të motit të ligë. Por, Tom Jones është në top formë dhe këtë e ka

treguar të hënën kur është rikthyer në skenë, në një koncert në Antalya të Turqisë. Ikona e muzikës tregoi se është mirë me shëndet, madje është edhe në formën e tij më të mirë derisa këndoi para një turme të madhe të fansave.



E rrallë

Qyteti Batman kërkon hartë me formën e superheroit

Batmani është një nga krahinat anadolliane e njohur për prodhimin e naftës në Turqi dhe emri i të cilit kujton filmat e animuar "Dark Knight" nga DC Comics. Kjo zonë e ka marrë emrin Batman nga bashkëngjitja e emrave të maleve Bati dhe Raman. Por, për ta bërë maksimumin e homonimit të pazakontë dhe zbavitës, tani



banorët kanë nisur në change.org një peticion online që kërkon që emri të korrespondojë edhe me kufijtë gjeografikë.

BARSOLETA E DITËS



Mësuesi, nxënësit: Na flit për Shekspirin. Sipas mendimit tënd, në qoftë se ai do të ishte ende gjallë, a do të mbetej njeri i shquar? Nxënësi: Patjetër, sepse ai tani do të ishte 412 vjeç.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetëm gjatë vikendit në ora 16:00

“INCREDIBLES 2” 3D

I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

Rolet: Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

Regjia: Brad Bird



FOTO E DITES



Banorët e shtyjnë një makinë pas përmbytjes në rajonin Bago, rreth 68 km larg nga Yangon, Mianmar. /AFP/

Në ora 18:20

“FUTURE WORLD”

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

Rolet: James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

Regjia: James Franco



Në ora 20:00

“ANT-MAN AND THE WASP” 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 58 min

Rolet: Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

Regjia: Peyton Reed



Në ora 22:00

“LOVING PABLO” (R)

Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 m

Rolet: Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.

Regjia: Fernando León de Aranoa



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

E jashtëzakonshme

Qeni, simbol i "ferrit" në Athinë, bashkohet me pronarët

Në Greqi zjarret shkrumbuan Atikën lindore, duke ua marrë jetën 81 personave. Në mes të katastrofës dhe makthit nga tragjedia, një fotografi e një qeni të bukur që u ngjiti majë një shkëmbi në mes të detit në Mati, ndërkohë që pylli dhe vilat digjeshin nga flakët, ka marrë



vëmendjen e medieve dhe rrjeteve sociale. Pas postimit të fotografisë në internet, shumë prej tyre u përpoqën t'i gjenin pronarët e saj. Përpjekjet ishin të suksesshme, pasi qeni Lua u ribashkua me pronarët.




DASHI

E keni shumë të qartë se çfarë duhet të bëni sot dhe si duhet të silleni me personat që nuk ndajnë të njëjtin mendim me ju.



DEMI

Edhe pse një nga bashkëpunëtorët tuaj nuk është treguar korrekt me ju, përsëri nuk do t'i bini në sy dhe do të vazhdoni çdo gjë si në fillim.



BINJAKËT

Nuk jeni shumë të qartë sot, sepse tjetër gjë thoni dhe ndryshe veproni. Keni disa çaste tensioni që do ta rrrumbullakojnë të gjithë ecurinë e ditës.



GAFORRJA

Nëse doni të jeni mirë me skuadrën që po punoni, sot duhet ta lini mënjane krenarinë tuaj dhe të bashkoheni edhe në oraret e vona.



LUANI

Po lini shumë takime përgjatë ditës sot dhe nuk do të mund t'i përballoni. Çdo gjë do të ndikojë në mbarëvajtjen e ditës dhe në humorin tuaj.



VI RGJËRESHA

Nuk keni shumë besim tek personat që ju rrinë pranë dhe kjo ju ka bërë të mbyllur në vetvete. Sot nuk do të jetë një ditë nga më të mirat.



PESHORJA

Sot duhet të jeni këmbëngulës dhe të çoni deri në fund një punë të nisur. Nëse testoni situata të ndryshme, do të kuptoni se sa pak ju mbështesin.



AKREPI

Duhet të jeni pak më të shkathët sot që në momentin që ju jepen oportunitetet të dini t'i shfrytëzoni. Nëse veproni siç duhet, do të keni përfitime.



SHIGJETARI

Po përtypni brenda vetes një ndjenjë që nuk është aspak e mirë. Keni përshtypjen që janë të tjerët që nuk janë korrekt.



BRICJAPI

Nuk mund të refuzoni një ftesë bërë në çastet e fundit sot. Do të shikoni që aty do të jetë ambienti të cilit i përkisni.



UJORI

Duhet të hiqni dorë nga situata dhe persona të njëjtë në jetën tuaj për të filluar një cikël të ri. Ndjeni që tashmë çdo gjë ka përfunduar.



PESHQIT

Keni marrë disa çaste pushimi për t'i qartësuar idetë me veten. Shumë persona pranë jush janë treguar oportunistë dhe mosmirënjohës.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

BASLE - PAOK SALONIKA

1

STURM GRAZ - AJAX

3+

HELSINKI - BATE BORISOV

1

Plot oferta për Balajn, e ardhmja afër Prishtinës

Ylli i futbollit të Pejës, Liridon Balaj, është gati të ndryshojë skuadër për ta ndjekur ëndrrën e çdo futbollisti që të zhvillohet sa më shumë si futbollist. Balaj për "Epokën e re" ka bërë me dije se fillimisht po synon të fitojë përvojë në futbollin e Kosovës, më pas ta ndjekë rrugën e ish-lojtarëve të Besës, Bernard Berishës dhe Fatos Beqiraj

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 31 KORRIK - Edicioni i futbollit 2017/2018 për futbollin pejan do të mbahet mend gjatë, pasi Besa klubi, që është krenaria e qytetit të Pejës, ka rënë për herë të parë nga Superliga, por ky edicion do të mbahet në mend edhe për zbulimin e yllit, Liridon Balaj. Ky i fundit, pavarësisht prej rezultateve jo të mira nga Besa, në aspektin personal ka shkëlqyer dhe kjo ka bërë që shumica nga klubet e elitës të vihen në kërkim të tij. "Kam filluar të luaj futboll në moshën 10-vjeçare në akademinë e klubit të Besës, kurse tash më është dhënë rasti të luaj në ekipin e parë. Jam shumë i lumtur", kishte qenë deklarata e Balajt në muajin maj për "Epokën e re".

Balaj ka folur të martën për gazetë, duke mos hezitur t'i tregoj edhe emrat e skuadrave që janë duke e kërkuar në këtë afat kalimtar. Ai ka konfirmuar se në mesin e tyre është edhe skuadra më e madhe në vend, Prishtina. "Jam duke stërvitur në Besë, por mendoj të largohem nga ky klub. Oferta kam nga shumica e klubeve, duke përfshirë edhe Drenicën, Lirinë dhe Prishtinën. Ende nuk kam vendosur se ku do ta vazhdoj karrierën, por sigurisht se në njërin prej skuadrave të



elitës", ka thënë ai. I pyetur se a po largohet nga Besa për shkak të rënies nga Vala Superliga, Balaj është përgjigjur: "Jo, mendoj të largohem pasi mendoj se është më mirë për karrierën time". "Çdo futbollist në botë e ka ëndërr të luajë në liga dhe skuadra sa më të forta. Personalisht dëshiroj të fitoj sa më shumë përvojë dhe në një të ardhme të afërt të angazhohem në ndonjë skuadër jashtë Kosovës", ka deklaruar Balaj.

Duhet cekur se skuadra e Besës ka nxjerrë shumë lojtarë që kanë bërë emër në Kosovë dhe jashtë saj. Ndër lojtarët kryesor që ka lënë gjurmë në futbollin vendor janë Haxhi Zeka, Valmir Bytyqi, Fetim Kasapi, Ilir Nallbani, Dugagjin Gashi, Fisnik Papuqi, Mensur Duraku, Krenar Vokshi e shumë të tjerë, kurse Bernard Berisha dhe Fatos Beqiraj janë dyshja që kanë shpërthyer edhe në arenën ndërkombëtare.

SHKURT

Sot tërhiqet shorti për Superligë dhe Ligën e Parë

Federata e Futbollit të Kosovës (FFK) ka njoftuar se sot (e mërkurë) do të bëhet tërheqja e shortit për edicionin e ri të garave në Superligë dhe Ligën e Parë. Shorti për Superligë do të tërhiqet në orën 13:00, kurse për Ligën e Parë në orën 13:30. FFK-ja ka ftuar përfaqësuesit e klubeve dhe mediet të jenë të pranishëm në tërheqjen e shortit.

FIBA Evropa vlerëson lart organizimin e Kosovës

FIBA Evropa ka uruar Federatën e Basketbollit të Kosovës (FBK) për organizim të mirë të Kampionatit Evropian - Divizioni C. Ky kampionat u organizua në Prishtinë nga 22 deri më 29 korrik. "Në emër të FIBA Evrope dua t'ju falënderoj juve dhe të gjithë anëtarët e Federatës e vullnetarët që ishin të shkëlqyeshëm gjatë Kampionatit Evropian U-18 të Divizionit C, që u organizua në Prishtinë. Më tej, përgëzoj edhe fitoren historike të ekipit tuaj", ka shkruar në letrën e urimit dërguar FBK-së drejtori ekzekutiv i FIBA Evropës, Kamil Novak.

Ferizaj me fushë të "Beach Volley"

Me përkrahjen e kryetarit të Komunes së Ferizajt, Agim Aliu, në Ferizaj shumë shpejt do të ndërtohet fusha e volejbollit në rërë. Kjo fushë me kërkesë të FVK-së do të ndërtohet në hapësirën afër Pallatit të Sporteve "Bill Clinton" në Ferizaj. Në kuadër të politikave të qeverisjes lokale për zhvillim e sportit, Ferizajt do t'i shtohet edhe kjo hapësirë sportive e cila do të mundësojë zhvillimin e garave në këtë sport. Në planet afatmesme të qeverisjes lokale të udhëhequr nga kryetari Agim Aliu janë edhe krijimi i vendhapësirave për ping-pong, fushave të tenisit, tablove të shahut, projekte këto që synohen të realizohen në këtë zonë, ku janë të fokusuar institucionet dhe aktiviteti sportiv.

Ministri Gashi: Sporti i Ragbit duhet të promovohet në Kosovë

PRISHTINË, 31 KORRIK - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka pritur sot në takim përfaqësuesit e Klubit të Ragbit në Pejë, "Kosova Roosters Rugby Club", me të cilët ka diskutuar për gjenden e këtij sporti dhe për aktivitetet që organizohen në sportin e ragbit në Kosovë.

Ministri Gashi i falënderoi drejtuesit e ragbit për vizitën dhe u premtoi atyre se do të angazhohet maksimalisht t'u ndihmojë në të gjitha aspektet e mundshme. "Do ta vazhdojmë mbështetjen e sportit të ragbit. Si një sport që nuk ka edhe shumë traditë tek ne, ne do të ndihmojmë në promovimin dhe avancimin e këtij sporti", ka thënë Gashi. Ndërsa sekretari i përgjithshëm i klubit pejan, Agnes Mulliqi, falënderoi ministrin Gashi për pritjen, kurse më pas e njoftoi rreth aktiviteteve të klubit. "Gjithsej jemi katër klube të ragbit. Jemi duke pritur ta formojmë edhe klubin e pestë, pastaj do ta formojmë Federatën e Ragbit", ka thënë Mulliqi.



Ronaldo kryen stërvitjen e parë si bardhezi

TORINO, 31 KORRIK - Ylli portugez Cristiano Ronaldo së bashku me yjet e tjerë të Juventusit: Dybala, Higuain, Cuadrado, Costa dhe

Bentacur zbritën në fushën e blertë të kompleksit stërvitor të Contiasës për t'u stërvitur. Kjo ishte stërvitja e parë e CR7 me bardhezinjtë, pas trans-

ferimit nga Reali i Madridit. Ndërkohë që Juventusit ndodhet në Amerikë ku po merr pjesë në turneun miqësor International Champions Cup.

Lojtarët u stërvitën nga ndihmësi i Allegrit, Aldo Dolçeti, i cili u kthye nga Amerika, për të qenë në dispozicion të lojtarëve në Torino.



Nowitzki vazhdon me Dallasin, vendos rekord në historinë e NBA-së

DALLAS, 31 KORRIK - Basketbollisti gjerman Dirk Nowitzki ka rinovuar edhe për një sezon kontratën me skuadrën e Dallas Mavericksit, me të cilën do të luajë edhe në moshën 40-vjeçare. Ky do të jetë sezoni i 21-të radhazi që shtatlarti gjerman do të luajë për Dallasin në NBA, duke vendosur një rekord, pasi asnjë lojtar më parë nuk ka luajtur më shumë se 20 sezone për të njëjtin ekip. Nowitzki i ka premtuar kështu besnikëri skuadrës teksane, ndërkohë që falë kontratës së re ai do të përfitojë 5 milionë dollarë sezonin e ardhshëm. Nowitzki ka zbankuar te Dallasi në vitin 1998, duke u zgjedhur i 9-ti në draft nga skuadra e Milwaukee, por më pas u transferua tek ekipi teksan, ku arriti t'i tregojë vlerat e tij, duke mbajtur të veshur fanellën me numrin 41. Për të luajtur gjithnjë me skuadrën e Mavericksit, basketbollisti gjerman shpesh ka hequr dorë nga oferta apo kontrata të majme,



duke fituar respektin e fansave. Në vitin 2011 ai fitoi titullin kampion me Dallasin dhe trofeun MVP të finaleve pas triumfit ndaj Miami Heat. Aktualisht ai renditet në vendin e gjashtë të shënuesve më

të mirë të NBA-së, me 31.187 pikë. Nowitzki është zgjedhur 13 herë në "All Star Game" dhe në 12 raste ka qenë titullar, një nga basketbollistët legjendarë të NBA-së, duke shkruar historinë e këtij sporti.

Elberi, Ozilit: Nuk kam pasur probleme me racizëm

MUNCHEN, 31 KORRIK - Ish-sulmuesi i Bayern Munchenit, Giovane Elber, ka insistuar se ai kurrë nuk është përballur me racizëm në Gjermani, pas pensionimit të Mesut Ozilit nga ekipi kombëtar i Gjermanisë. Ozili pohoi në deklaratën e tij të pensionimit nga kombëtarja se do ta bënte një gjë të tillë për shkak të racizmit dhe mungesës së respektit pas eliminimit të Gjermanisë nga Kupa e Botës qysh në fazën grupore. Mesfushori i Arsenalit po ashtu theksoi se mënyra se si Federata e Futbollit e Gjermanisë (DFB) e kishte trajtuar atë, kishte bërë që ai të mos e ndiente më dëshirën për ta veshur fanellën e ekipit kombëtar. Duke e akuzuar presidentin e DFB-së për racizëm, Ozil kishte deklaruar: "Unë jam gjerman kur fitojmë, por jam emigrant kur humbim". Elber insiston se ai vetë kurrë nuk ka qenë subjekt i një trajtimi të tillë, kur luante në Gjermani, në nëntë sezonet që e përfaqësoi Bayern Munichun. I pyetur nga "Goal" nëse ishte përballur ndonjëherë



me racizëm në Bundesligë, Elber u përgjigj: "Jo, në Gjermani jo, fatmirësisht. Nuk kam pasur probleme me racizëm. Jo unë, jo familja dhe fëmijët e mi. Gjithçka ka shkuar shumë mirë, dhe të

gjithë më respektonin në të njëjtën mënyrë, pavarësisht se kush ishte, gjithmonë me respekt. Në rastin e Ozilit mendoj se ishte diçka që u bë pa menduar shumë".

SHKURT

Mina: Çdo ditë humbisja nga 50 euro me Messin dhe Suarezin

Mbrojtësi i Kolumbisë, Yerry Mina, ka zbuluar se kur ishte transferuar te Barcelona kishte humbur çdo ditë nga 50 euro në stërvitje me Leo Messin dhe Luis Suarezin. "Kur fillova në klub, fillova të bëja baste me Lionel Messin dhe Luis Suarezin për të krijuar atmosferë të mirë. Luanim me gjuajtje të lira në stërvitje, por çdo ditë po humbisja nga 50 euro. Përfundova çdo ditë duke humbur nga 50 euro, pasi ata janë përbindës dhe mund ta fusin topin ku të duan. Ata janë njerëz të mrekullueshëm dhe magjistarë me topin", ka thënë Mina.

Lopetegui: Emocionuese të përgatitjet ekipi pa CR7

Julen Lopetegui ka thënë se do të jetë një sfidë për ta përgatitur ekipin pa Cristiano Ronaldon. Ai e quajti portugezin si njërin nga më të rëndësishmit në histori të Real Madridit. Ronaldo është një nga lojtarët më të rëndësishëm në histori të klubit. Ai e shprehu dëshirën për t'u larguar dhe klubi nje trashëgiminë e jashtëzakonshme që e ka lënë ai. Do të jetë emocionuese që të përgatitim një ekip pa Ronaldon. Nuk kam asnjë dyshim që mund t'ia dalim, duke parë lojtarët fantastikë që i kemi në skuadër", ka thënë Lopetegui.

Sarri preferon Lewandowskin para Higuainit

Gonzalo Higuain nuk është në planet e Chelseat për këtë afat kalimtar. Trajneri Maurizio Sarri po e kërkon sulmuesin aktual të Bayern Munchenit, Robert Lewandowski, njofton "Daily Star". Sulmuesi polak ishte i lidhur me një kalim në skuadrën e Real Madridit, por interesimi i Chelseat duket shumë më serioz dhe ky transferim pritet të kryhet shumë shpejt për faktin se ky afat kalimtar mbyllet brenda nëntë ditësh.

PSG-ja nuk e shet Cavanin

Trajneri i Paris Saint-Germainit, Thomas Tuchel, e ka përjashtuar mundësinë e largimit të sulmuesit Edinson Cavanit nga klubi francez këtë verë. Javën e kaluar u raportua se sulmuesi uruguaiian dëshironte t'i bashkohej Real Madridit, të cilët e kërkonin për ta zëvendësuar Cristiano Ronaldon. "Kam folur me Cavanin dhe ai nuk më ka thënë asgjë rreth largimit. Ai ka thënë se mezi po priste të na bashkohej dhe se dëshiron të fitojë gjithçka me skuadrën tonë. Ai është lojtar kyç për ne dhe nuk e mendojmë ta shesim", ka thënë Tuchel.

Alaba: Kovaqi na jep siguri për të ardhmen

David Alaba është ndër lojtarët më të mirë në skuadrën e Bayern Munchenit. Mbrojtësi austriak e ka lavdëruar trajnerin e ri Niko Kovaq. "Ju mund ta ndjeni përvojën që ai ka si ish-lojtar, por edhe si trajner tani. Kovaq është duke u përpjekur ta sjellë filozofinë e tij në ekip. Natyrisht, do të duhet kohë. Situata është efikase, te Bayern Munich ka një atmosferë të mrekullueshme, brenda dhe jashtë fushës. Ai flet shumë me ne dhe na jep siguri për të ardhmen".

Në bazë të nenit 21 të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjit Nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit bazik për Ndërmarrjet Publike, Bordi i Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike "Qendra Multifunkionale" SHA me datën 01.08.2018 shpall

KONKURS PËR VENDE PUNE

Titulli pozitës: -Kryeshef Ekzekutiv
-Zyrtar Kryesor për Financa / Thesar
-Këshilltar i Përgjithshëm / Sekretar

Entiteti: Qendra Multifunkionale

Vendi: Mitrovicë

Afati për aplikim: 01.08.2018 deri me 15.08.2018

Përshkrim

Qendra Multifunkionale" SHA është Ndërmarrje Publike Lokale në pronësi me 100% aksioneve të saj nga Komuna e Mitrovicës. Të ardhurat më të mëdha të kësaj ndërmarrjeje gjenerohen nga aktivitetet e hyrje-daljeve të ndërmarrjes . Qendra Multifunkionale" SIA është në kërkim të zytareve kryesor të ndërmarrjes me kualifikim, me integritet të njohurive, përvojë të nevojshme profesionale që do të udhëheqin ndërmarrjen në përputhje me parimet e njohura për qeverisjen e ndërmarrjeve publike dhe të vazhdojnë zhvillimin e shërbimeve në një ambient konkurrues.

Vendi i punës: Kryeshef Ekzekutiv nr. reference 01/2018

Detyrat dhe përgjegjësitë

Duke i raportuar Bordit të Drejtorëve, Kryeshefi Ekzekutiv do të jetë zyrtari kryesor ekzekutiv i kompanisë dhe do të përbush detyrat e veta të përditshme në pajtim me Ligjin për Ndërmarrjet publike, rregulloret dhe vendimet e Bordit.

Përgjegjësitë kryesore janë:

- Zhvillimi i mëtejshëm i fokusit strategjik për ndërmarrjen që do të shërbejë si udhërrëfyes për planet strategjike dhe të biznesit;
- Ofrimi i lidershit dhe udhëzimit në formulimin dhe implementimin e strategjive të biznesit dhe kulturës për të arritur vizionin e ndërmarrjes;
- Drejtimi dhe koordinimi i aktiviteteve të ndërmarrjes për të arritur planet e biznesit;
- Vendosja e një ambienti të biznesit dhe të kulturës që ndihmon për të ndërtuar kapacitetet e brendshme;
- Udhëheqja e zhvillimit dhe shpalljes së praktikave më të mira, standardeve dhe kodeve të praktikës në tërë sferën e aktiviteteve të njësitëve të biznesit dhe atyre përkatëse të ndërmarrjes, duke filluar nga themelimi dhe edukimi, e deri në implementim dhe shpërndarje;
- Iniciimi dhe zhvillimi i partneriteteve strategjike nga e cila përfiton ndërmarrja në aspektin e rritjes së dhe përfitimeve financiare;
- Sigurimi i zhvillimit adekuat të brendshëm dhe kontrollit të sistemeve dhe procedurave në të gjitha njësitet e biznesit të ndërmarrjes.

Edukimi

- Diplomë universitare nga fusha e shkencave ekonomike. Preferohet edukim i avancuar në sektorin relevant.

Përvoja e punës

- Minimum 5 vjet përvojë pune relevante, ku prej të cilave së paku 3 vite në menaxhment të nivelit të lartë-në fushën e administrimit të biznesit, financave, konsulentë në biznes ose në një fushë tjetër që lidhet ngushtë me veprimtarinë e Ndërmarrjes Publike. Eksperienca në nivel të lartë të menaxhmentit në ambient konkurrues është përparësi;
- Përvojë e suksesshme në implementimin e ndryshimit të menaxhmentit dhe/ose ndryshimeve të shpejta ose të reja të tregjeve dhe industrive;
- Përvojë dhe arritje të dëshmuara brenda sektorit të ndërmarrjeve, si dhe njohuri dhe kuptimi i rajonit dhe kulturës është përparësi e dukshme.

Aftësitë

- Udhëheq përmes vizionit dhe vlerave;
- Aftësi të për të menduar dhe vepruar në mënyrë strategjike duke mbajtur në të njëjtën kohë perspektivë pragmatike;
- Njohuri të financiare, me aftësinë për të kuptuar dhe interpretuar të dhënat financiare për vendim marrje;
- Aftësi të për të ndërtuar, trajnuar dhe zhvilluar ekipin ekzekutiv të menaxhmentit;
- Aftësi të forta ndërpersonale / bindëse;
- Njohuri të mira të gjuhës angleze në të shkruar dhe të folur është përparësi;
- Mendjeprehtësi biznesi dhe njohuri të mira të ndërmarrjeve;
- Aftësi të forta konceptuale dhe analitike dhe
- Aftësi të shkëlqyeshme organizative.

Vendi i punës: Zyrtar Kryesor për Financa / Thesar nr. reference 02/2018

Përgjegjësitë kryesore janë:

- Udhëheq , organizon , kordinon punët financiare , konform ligjeve ,rregullave dhe akteve normative;
- Siguron zbatimin e politikës financiare sipas vendimeve të Bordit të Drejtorëve dhe Kryeshefit Ekzekutiv të kompanisë.
- Mbikqytet dhe përgjegjet për të gjitha fondet e kompanisë.
- Përpilon llogarinë përfundimtare dhe perioidike të cilat kërkohen nga organet më të larta .
- Përgatit planin e të hyrave të përgjithshme bruto dhe shpërndarjen e tyre në vijim.
- Mer pjesë në hartimin e planit të biznesit të kompanisë për vitin në vijim
- Jep të dhëna të nevojshme për Kryeshefin Ekzekutiv dhe Bordin e Drejtorëve në kohë perioidike dhe përfundimtare.
- I kryen të gjitha punët nga lëmia financiare , dhe punët që kërkohen nga Kryeshefi Ekzekutiv dhe Bordi i Drejtorëve .
- Kryen edhe punët tjera me urdhëresë të Kryeshefit Ekzekutiv dhe Bordit të Drejtorëve
- Për punën e vetë i përgjigjet Ligjit , Kryeshefit Ekzekutiv dhe Bordit të Drejtorëve.

Edukimi

- Diplomë universitare nga fusha e Financave ose fusha të ngjashme. Preferohet edukim i avancuar në sektorin relevant. Njohja e ndonjë prej gjuhëve zyrtare në Republikën e Kosovës konsiderohet përparësi.

Përvoja e punës

- Obligohet të ketë njohuri rreth legjislacionit që lidhet me financa publike dhe me fushën e financave.

Vendi i punës: Këshilltar i Përgjithshëm / Sekretar i Ndërmarrjes nr. reference 03/2018

Detyrat dhe përgjegjësitë

Duke i raportuar Bordit të Drejtorëve, Këshilltari i Përgjithshëm / Sekretari i Ndërmarrjes përkujdeset për ligjshmërinë e fushëveprimtimit të BtD dhe është përgjegjës për menaxhimin e çështjeve administrative të Bordit të Qendrës Multifunkionale

Detyrat / përgjegjësitë kryesore:

- Siguron të dhënat e nevojshme, mirëmban dokumentet dhe procesverbalin nga takimet e Bordit të Drejtorëve të Qendra Multifunkionale" SIA ;
- Përgatit dhe koordinon të gjitha aktivitetet rreth mbledhjeve të rregullta dhe jashtëzakonshme të BtD;
- Siguron shënime, raportet dhe prezantimet e duhura për Takimin të Përgjithshëm të aksionarëve dhe të takimeve të Bordit të Drejtorëve;
- Vepron si agjent i Ndërmarrjes për pranimin e njoftimeve;
- Përkujdeset në parim për bazën legale të vendimeve të Ndërmarrjes;
- Planifikon, drejton dhe koordinon aktivitetet operacionale të nivelit më të lartë të menxhmentit dhe Qendrës Multifunkionale;
- Konsultohet me KE të Qendrës Multifunkionale dhe Anëtarët e Bordit të Drejtorëve për themelimin e politikave dhe bizneseve;
- Drejton aktivitetet e shërbimeve të menaxhmentit për të planifikuar procedurat;
- Siguron qarkullimin e informatave nga BtD për Menaxhmentin Ekzekutiv, dhe raporton përmes KE në BeD për veprimet e ndërmarrja;
- Përkujdeset për formën e unifikuar të akteve komunikuese të brendshme dhe jashtë ndërmarrjes;

Kualifikimi, përvoja dhe të tjera:

- Diplomë universiteti në juridik, administratë dhe menaxhim të ndërmarrjes / korporatës;
- Aftësi të dëshmuara të udhëheqjes, me zotësinë që në mënyrë efektive të punojë nëpër të gjitha nivelet dhe funksionet brenda biznesit;
- Aftësi në zgjidhjen e problemeve me kapacitet për të përqendruar në simptomat në zhvillimin e zgjidhjeve afat gjata;
- Aftësi të forta bindëse/ndër personale;
- Aftësi të shkëlqyeshme organizative;
- E preferuar njohja e gjuhës angleze.

Aplikacionet mund të merren online në www.kk.rks-gov.net ose në zyrën për shërbim të qytetarëve në Komunën e Mitrovicës.

Procedura e aplikimit:

- Aplikacioni për punë;
 - CV-ja;
 - Letër motivuese;
 - Dëshmi mbi përgaditjen profesionale;
 - Certifikata e lindjes e re;
 - Letërnjoftimi fotokopje;
 - Përvoja e punës nga lëmia profesionale – financiare dhe e kontabilitetit (për pozitë që nevojiten);
 - Dëshmi lidhur me njohuritë tjera.
- Vërtetimi nga Gjykata se nuk jeni nën hetime dhe Dokumentet e dorzuara nuk kthehen

Vërejtje: Të gjithë dokumentacionin duhet të dorzohet i mbyllur në zarf.

Vetëm kandidatët të cilët hyjnë në listën e ngushtë do të kontaktohen dhe ftohen për intervistë.

Gani Rrustemi
KK.Bordit të drejtorëve

Date: 01.08.2018

Në osnovu člana 21. Zakona br. 03 / L-087 o Javnim preduzećima i Zakona br. 04 / L-111 o Izmeni i dopuni Osnovnog zakona o Javnim preduzećima, Upravni odbor Javnog preduzeća "Multifunkcionalni centar" AD dana 01.08.2018 objavljuje:

OGLAS ZA RADNA MESTA

Naziv položaja: - Izvršni direktor
- Glavni Zvaničnik za finansije / Trezor
- Opšti savetnik/ Sekretar

Entitet: Multifunkcionalni Centar

Mesto: Mitrovica

Rok za prijavlivanje: 01.08.2018 do 15.08.2018

Opis

Multifunkcionalni centar "AD je Lokalno javno preduzeće u 100%-tnom vlasništvu akcija od strane opštine Mitrovica. Najveći prihodi ovog preduzeća generišu se poslovanjem prihoda-rashoda preduzeća. Multifunkcionalni centar "AD je u potražnji rukovodećih zvaničnika preduzeća sa kvalifikacijom, sa integritetom znanja, potrebnim profesionalnim iskustvom koji će rukovoditi preduzeće u skladu sa priznatim principima za upravljanje javnim preduzećima i nastaviti razvoj usluga u konkurentnom okruženju .

Radno mesto: Izvršni direktor referentni br. 01/2018

Zadaci i odgovornosti

Izveštavajući Odboru direktora, Izvršni direktor će biti glavni izvršni šef kompanije i vršić svoje dnevne poslove u skladu sa Zakonom o Javnim preduzećima, propisima i odlukama Odbora.

Glavne odgovornosti su:

- Dalji razvoj strateškog fokusa za preduzeće koje će služiti kao vodič za strateške i poslovne planove;
- Pružanje vodstva i uputstva u formulisanju i implementaciji strategija biznisa i kulture kako bi se ostvarila vizija preduzeća;
- Usmeravanje i koordinacija poslovnih aktivnosti za postizanje poslovnih planova;
- Uspostavljanje okruženja za iznes i kulturu koje pomaže u izgradnji unutrašnjih kapaciteta;
- Rukovođenje razvoja i proglašenja najboljih praksi, standarda i kodeksa prakse u čitavoj sferi aktivnosti poslovnih jedinica i onih koji podržavaju preduzeće, počev od osnivanja i obrazovanja, do implementacije i distribucije;
- Iniciranje i razvijanje strateških partnerstava od kojih ima korist preduzeće u pogledu rasta i finansijske dobiti;
- Obzbeđivanje adekvatnog unutrašnjeg razvoja i kontrolo sistema i procedura u svim poslovnim preduzećima.

Obrazovanje

- Univerzitetska diploma iz oblasti ekonomije. Unapredno obrazovanje u relevantnom sektoru, poželjno

Radno iskustvo

- Minimum 5 godina relevantnog radnog iskustva, od kojih najmanje 3 godine u višem menadžmentu - u oblasti poslovne administracije, finansija, poslovnog savetovanja ili u nekoj drugoj oblasti koja je blisko povezana sa aktivnostima Javnog Preduzeća. Iskustvo upravljanja na visokom nivou u konkurentnom okruženju je prioritet;
- Uspesno iskustvo u sprovođenju upravljanja i promena i / ili brzim ili novim promenama na tržištima i industrijama;
- Iskustvo i dostignuća u okviru preduzeća, kao i znanje i razumevanje regiona i kulture, očigledna je prednost.

Sposobnosti

- Rukovodi kroz viziju i vrednosti;
- Sposobnost za strateško mišljenje i delovanje držajući istovremeno pragmatiku perspektivu;
- Finsijska znanja, sa sposobnošću razumevanja i interpretiranja finansijskih podataka za donošenje odluka;
- Sposobnost za izgradnju, obuku i razvoj izvršnog tima upravljanja;
- Jaki međuosobni odnosi / ubedljivost;
- Dobro poznavanje engleskog jezika u pisanju i govoru je prednost;
- Ostroumnost za biznes i dobro poznavanje preduzeća;
- Jake konceptualne i analitičke sposobnosti i
- Odlične organizativne sposobnosti.

Radno mesto: Glavni Zvaničnik za finansije / Trezor referentni br. 02/2018

Glavne odgovornosti su:

- Sprovodi, organizuje, koordinira finansijske poslove, u skladu sa zakonima, propisima i normativnim aktima;
- Obzbeđuje sprovođenje finansijske politike u skladu sa odlukama Odbora direktora i Glavnog izvršnog direktora kompanije.
- Nadgleda i odgovora za sva sredstva kompanije.
- On sastavlja konačne i periodične račune koje zahtevaju najviši organi.
- Priprema plan bruto zarade i distribuirati isti.
- Obzbeđuje potrebne podatke za Izvršnog direktora i Odbor direktora na periodičnoj i završnoj osnovi.
- Obavlja sve poslove u finansijskom polju, i radove koji zahtevaju Glavni izvršni direktor i Odbor direktora.
- Takođe vrši i druge poslove po nalogu Glavnog izvršnog direktora i Odbora direktora
- Za svoj rad odgovara Zakonu, Glavnom izvršnom direktoru i Upravnom odboru.

Obrazovanje

- Univerzitetska diploma iz polja finansija ili sličnih oblasti. Unapredno obrazovanje u relevantnom sektoru je poželjno. Poznavanje bilo kog zvaničnog jezika u Republici Kosovo se smatra prioritetom.

Radno iskustvo

- Obavezno je znati zakonodavstvo vezano za javne finansije i finansije.

Radno mesto: Opšti savetnik / Sekretar preduzeća referentni br.03/2018

Zadaci i odgovornosti

Izveštavajući Odboru direktora, generalni savetnik /sekretar preduzeća bavi se zakonitošću opsega delatnosti OD-a i odgovoran je za upravljanje administrativnim stvarima Odbora Multifunkcionalnog centra.

Zadaci / glavne odgovornosti:

- Obzbeđuje potrebne podatke, dokumentaciju i vodi evidenciju o sastancima Upravnog odbora multifunkcionalnog centra "AD;
- Priprema i koordinira sve aktivnosti na redovnim i vanrednim sastancima OD;
- Osigurava odgovarajuće napomene, izveštaje i prezentacije za Skupštinu akcionara i sednice Odbora direktora;
- Deluje kao agent preduzeća za prijem obaveštenja;
- U načelu održava pravnu osnovu odluka Preduzeća;
- Planira, usmerava i koordinira aktivnosti na najvišem nivou operativnog menadžmenta i Multifunkcionalnog centra;
- Konsultuje se sa IS Multifunkcionalnog centra i članovima Upravnog odbora za uspostavljanje politika i poslovnih planova;
- Rukovodi aktivnost usluga upravljanja kako bi se planirale procedure;
- Obzbeđuje protek informacija iz UO za Izvršnu upravu, i izveštava kroz IS u OD za preduzete akcije;
- Stara se o jedinstvenom obliku internih i eksternih komunikacija preduzeća;

Kualifikacije, iskustvo i ostalo:

- Univerzitetska diploma iz prava, administracije i menadžmet preduzeća / korporacije;
- Dokazane leaderske veštine sa mogućnošću efikasog rada na svim nivoima i funkcijama unutar biznisa;
- Sposobnost rešavanja problema sa kapacitetom da se usredsredi na simptome u razvoju dugoročnih rešenja;
- Snažne uverljive / međuljudske veštine;
- Odlične organizativne sposobnosti;
- Poznavanje engleskog jezika, poželjno.

Prijave možete uzeti online u www.kk.rks-gov.net ili u kancelariji za usluge građanima u opštini Mitrovica.

Procedura prijavlivanja:

- Prijava za posao;
- CV;
- Motivaciono pismo;
- Dokazi o stručnoj spremi;
- Novi sertifikat rođenih;
- I.čna karta, fotokopija;
- Stručno iskustvo u finansijskom i računovodstvenom polju (za pozicije za koje je potrebno);
- Dokazi koji se odnose na druga znanja,
- Potvrdu od strane Suda da nije pod istragom i
- Isporučeni dokumenti se ne vraćaju.

Napomena: Sva dokumentacija mora biti uručena zapečaćena u kovertama. Samo kandidati koji uđu u užu listu će biti kontaktirani i pozvani na intervju.

Gani Rrustemi
PK.Odbora direktora

01.08.2018

N.P.K "TRAFIKU URBAN" SH.A. - K O N K U R S P U N E

Inkurajohet gjinia femërorë për të aplikuar në këtë konkurs.

- Pozita e punës. Konduktër/e
- Numri i pozitave: 90 (nëntëdhjetë)
- Kohëzgjatja e punës: 1 vit me mundësi vazhdimi

Detvrat dhe përgjegjësitë:

- Kujdeset për hyrje dhe dalje të udhëtarëve në çdo stacion për autobusët e N.P.K "Trafikut Urban" SH.A;
- Ngarkohet rregullisht me arkë fiskale – letër të saj dhe fletë-urdhëresë të arkës nga arkëtari apo personi tjetër i autorizuar;
- Furnizon udhëtarëve me kupon fiskal në kohë dhe me rregull.

Kualifikimet dhe aftësitë:

